



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

***PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 02.06.2021)*

***Pika 1 shtesë e rendit të ditës me objekt:*** Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin me short të relatorit për zhvillimin e procedimit disiplinor nr.3/2021, të filluar ndaj magjistrates {...}, me detyrë Zëvendëskryetare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan”, i përgatitur nga Komisioni Disiplinor (relator z. Medi Bici).

***Drejton mbledhjen fillimisht Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Maksim Qoku dhe më pas Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:19 dhe mbaroi në orën 12:32.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                                  |                                 |
|----------------------------------|---------------------------------|
| <b><i>1. Maksim Qoku</i></b>     | <b><i>(zëvendëskryetar)</i></b> |
| <b><i>2. Medi Bici</i></b>       | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b><i>3. Fatmira Luli</i></b>    | <b><i>(anëtare)</i></b>         |
| <b><i>4. Dritan Hallunaj</i></b> | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b><i>5. Brunilda Kadi</i></b>   | <b><i>(anëtare)</i></b>         |
| <b><i>6. Ilir Toska</i></b>      | <b><i>(anëtar)</i></b>          |

7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
9. *Marçela Shehu* (anëtare)
10. *Erjon Muharremaj* (anëtar)

**Shënim:** Nuk mori pjesë në shqyrtimin e kësaj çështjeje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *zonja Naureda Llagami*, për shkak të një angazhimi në Këshill.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
4. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
5. *Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
6. *Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*
7. *Përfaqësues të medias.*

#### **RENDI I DITËS:**

1 (shtesë). Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin me short të relatorit për zhvillimin e procedimit disiplinor nr.3/2021, të filluar ndaj magjstrates {...}, me detyrë Zëvendëskryetare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan”, i përgatitur nga Komisioni Disiplinor (relator z. Medi Bici).

***Maksim Qoku:*** Përshëndetje të nderuar anëtarë!

Po fillojmë mbledhjen e radhës së datës 2 qershor 2021. Nisur nga fakti që Kryetarja është e angazhuar në detyra të Këshillit, sot mbledhja do të drejtohet nga unë Zëvendëskryetari, bazuar në nenin 60 të ligjit nr. 115/2016 për Qeverisjen.

Përpara se të relatoj në fakt rendin e ditës, në momentet e fundit, siç mbase edhe jeni në dijeni, në adresat tona të e-mail-it ka ardhur një kërkesë e zotit Bici (kryetar i

Komisionit të Disiplinës), në lidhje me shtimin e një çështjeje në rendin e ditës. Kërkesa është në lidhje me caktimin me short të relatorit për zhvillimin e procedimit disiplinor nr.3/2021, të filluar ndaj magjistrates {...}, me detyrë Zëvendëskryetare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Duke qenë që është një kërkesë e momentit të fundit, nisur nga rëndësia e saj, pasi shorti duhet të hidhet brenda afatit 3-ditor, bazuar në nenin 66 të ligjit nr. 115/2016, do duhet që ta kalojmë në votim, për sa i përket pranimet ose jo në rendin e ditës.

Nëse nuk ka diskutime, mund ta kalojmë në votim.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Maksim Qoku:** Dakord.

Atëherë, shtohet edhe kjo çështje në rendin e ditës.

Fillojmë me prezantimin e rendit të ditës, aktualisht kemi të bëjmë me 16 çështje dhe konkretisht:

Çështja e parë është: Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Durrës.

Çështja e dytë: Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës dhe Gjykatën e Apelit Korçë për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 129 dhe nr. 132, datë 01.05.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”.

Çështja e tretë: Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 129, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”.

Çështja e katërt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 129, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”.

Çështja e pestë: Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të katër kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 125, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”.

Çështja e gjashtë: Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të katër kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 117, nr. 118 dhe nr. 119, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”.

Çështja e shtatë: Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës dhe Vlorë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 129, datë 01.04.2021 dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 135, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”.

Çështja e tetë: Shqyrtimi i projektvendimit “Për shqyrtimin e kërkesës për daljen në pension të parakohshëm të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, z. {...}”.

Çështja e nëntë: Shqyrtimi i dy projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës:

“Për fillimin e procedurave të përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 174, datë 28.05.2020 dhe nr. 392, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”;

“Për fillimin e procedurave të përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 394 dhe 395, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Çështja e dhjetë: Shqyrtimi i projektvendimit “Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës”.

Çështja e njëmbëdhjetë: Shqyrtimi i projektvendimit “Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për pozicionet e lira në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë”.

Çështja e dymbëdhjetë: Shqyrtimi i dy projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës:

“Për komandimin në Skemën e Delegimit të gjyqtarit z. {...}”;

“Për caktimin e gjyqtarit të Skemës së Delegimit z. {...} në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”

Çështja e trembëdhjetë: Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së përsheptuar të vlerësimit etik dhe profesional viti kalendarik 2019, për gjyqtarët që kanë plotësuar kriteret ligjore të kandidimit për ngritje në detyrë dhe që kanë ushtruar detyrën e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë”.

Çështja e katërbëdhjetë: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfshirjen e kandidates znj. {...} në procedurat e komandimit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Çështja e pesëmbëdhjetë: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme.

Çështja e gjashtëmbëdhjetë: Caktimi me short të relatorit për zhvillimin e procedimit disiplinor nr.3/2021, të filluar ndaj magjistrates {...}, me detyrë Zëvendëskryetare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Ky ishte rendi i ditës.

Nëse jeni dakord me rendin e ditës.

Nisur nga kërkesa e disa anëtarëve, kalojmë në shqyrtim çështjen e fundit të sapo pranuar në rendin e ditës, në lidhje me caktimin me short të relatorit për magistraten znj. {...}.

Fjala i jepet zotit Bici.

**Medi Bici:** Faleminderit, zoti Nënkryetar!

Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, në datë 01.06.2021, është depozituar kërkesa e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magistrates {...}, me detyrë zëvendëskryetare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Kërkesa për fillimin e procedimit disiplinor mbështetet në nenin 194 të ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, dhe në nenin 138 të ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 140, pika 2, shkronja "a" e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 103, shkronja "dh" e ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe shkelje të Kodit të Etikës, Seksioni "C", "Parimi i integritetit", shkronja "a" dhe "b", Seksioni "Ç" "Parimi i sjelljes së hijshme dhe me vetëpërmbytje", pika 9, shkronja "c".

Në kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka paraqitur propozimin për caktimin ndaj magistrates {...}, të masës disiplinore "Shkarkim nga detyra", të parashikuar nga neni 140, pika 2, shkronja "a" e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 105, pika 1, shkronja "dh" dhe neni 111, pika 1 e ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Në raportin e hetimit, të hartuar nga inspektorët pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë i Drejtësisë, Znj.{...}, z. {...} dhe Znj. {...}, të miratuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, është kërkuar dhe pezullimi nga detyra e magistrates deri në përfundim të procedimit disiplinor, sipas parashikimeve të nenit 152 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Në kushtet kur kërkesa e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor, inicion një procedurë individuale administrative në Këshill, e cila ka lidhje me statusin profesional të magistrates {...}, në zbatim të nenit 63 të ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, nga ana e Këshillit duhet të procedohet me hedhjen e shortit për caktimin e relatorit. Relator do të caktohet njëri nga anëtarët e Komisionit Disiplinor.

Bazuar në nenin 152 dhe nenin 155 të ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, vendimi për pezullimin nga detyra duhet të merret nga Këshilli brenda tre ditëve pas paraqitjes së kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në rastin konkret jo me vonë se data 07.06.2021. Si pasojë duhet të procedohet me caktimin menjëherë të relatorit të çështjes, sipas parashikimeve të nenit 27, pika 2 të rregullores "Për procedurat disiplinore në Këshillin e Lartë Gjyqësor".

Pas caktimit me short të relatorit, duhet të procedohet me caktimin e mbledhjes plenare të radhës, në të cilën Këshilli, mbi relacionin e relatorit, mund të vendosë mbylljen e procedimit disiplinor pa zhvilluar seancë dëgjimore, sipas nenit 139 të ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ose caktimin e datës së seancës dëgjimore sipas nenit 138/2 të këtij ligji.

Për këto arsye, kërkohet që të caktohet me short njëri prej anëtarëve të Komisionit Disiplinor.

***Maksim Qoku:*** Faleminderit, zoti Bici!

Atëherë, administrata të procedojë me shortin.

Procedura e shortit:

Futen me radhë në enën e qelqit shiritat e letrës me emrat e tre anëtarëve të Komisionit Disiplinor: z. Medi Bici, z. Maksim Qoku dhe z. Dritan Hallunaj.

Përzgjidhet më pas emri i anëtarit relator:

Nga shorti rezulton i përzgjedhur anëtari z. Maksim Qoku.

***Maksim Qoku:*** Faleminderit administrata!

Relatori është njëri prej anëtarëve të Komisionit.

Caktohet z. Maksim Qoku.

\* \* \*

(Pika 1 shtesë e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 02.06.2021)*

**Pika 2 e rendit të ditës me objekt:** Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Durrës (shtyrë nga mbledhje e datës 26.05.2021).<sup>1</sup>

*Drejton mbledhjen fillimisht Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Maksim Qoku dhe më pas Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.*

*Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:19 dhe mbaroi në orën 12:32.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <i>1. Maksim Qoku</i>     | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>2. Medi Bici</i>       | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>3. Fatmira Luli</i>    | <i>(anëtare)</i>         |
| <i>4. Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>5. Brunilda Kadi</i>   | <i>(anëtare)</i>         |

<sup>1</sup> Sipas rendit të ditës kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e para.

6. *Ilir Toska* (anëtar)
7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
9. *Marçela Shehu* (anëtare)
10. *Erjon Muharremaj* (anëtar)

*Shënim:* Nuk mori pjesë në shqyrtimin e kësaj çështjeje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *zonja Naureda Llagami*, për shkak të një angazhimi në Këshill.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
4. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
5. *Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
6. *Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*
7. *Artur Metani, Inspektor i Lartë i Drejtësisë.*
8. *Përfaqësues të medias.*

#### **RENDI I DITËS:**

2. Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Durrës (shtyrë nga mbledhje e datës 26.05.2021).

*Maksim Qoku:* Kalojmë në çështjen tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë me zhvillimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Durrës.

Të thirret në sallë Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

*(Hyn në sallën e mbledhjes Inspektori i Lartë i Drejtësisë, zoti Artur Metani.)*

**Maksim Qoku:** Hapim seancën dëgjimore në lidhje me procedimin disiplinor.

Kuorumi i Këshillit është verifikuar me hapjen e mbledhjes plenare.

Bëjmë verifikimin e palëve.

Prezent është zoti Metani.

**Artur Metani:** Artur Metani, Inspektor i Lartë i Drejtësisë.

**Maksim Qoku:** Dhe prezenca e magjistratit apo mbrojtësit të tij, siç edhe është në dukje, është në mungesë.

Atëherë, më lini të bëj një farë referimi të situatës së deritanishme nisur edhe nga fakti që do t'i shërbejë personave që janë prezent 'online'.

Kjo seancë vijon nga data 26 maj i këtij viti, ku Këshilli për shkak të mosparaqitjes së magjistratit vendosi shtyrjen e saj për ditën e sotme për t'i dhënë mundësi për t'u paraqitur dhe për t'u dëgjuar.

Me shtyrjen e seancës dëgjimore për datë 2 qershor 2021, dhe përsëritjen e njoftimit, u procedua me caktimin e një afati të ri, për sa i përket paraqitjes së magjistratit {...}, të një parashtrere me shkrim.

Për njoftimin e seancës dëgjimore dhe fillimin e procedurës disiplinore, magjistratit {...} i janë dërguar, në adresën e deklaruar të vend{...}mit (Rruga {...} shkresat nr. {...} prot., datë 26.05.2021 dhe nr. {...} prot., datë 26.05.2021. Këto shkresa i janë dërguar për njoftim, me anë të shërbimit postar dhe ftuesit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Ato rezultojnë të pa komunikuar. Konkretisht, këto shkresa janë kthyer me shënimin e shërbimit postar "objekt i pa kërkuar" si dhe shënimin e ftuesit të Këshillit "Z. {...} nuk u gjet në shtëpi, gjithashtu u kontaktua në numrin e telefonit dhe nuk u përgjigj...."

Aktet e njoftimit, si më lart cituar, i janë komunikuar magjistratit edhe në dy adresa e-mail, në datë 27.05.2021 (adresa: {...}@gjykata.gov.al dhe {...}@{...}.com). Në

këto adresa është kërkuar dhe konfirmimi i tij për marrjen e e-mail-it, konfirmim i cili nuk është kthyer.

Gjithashtu lidhur me caktimin dhe njoftimin e seancës dëgjimore është kontaktuar dhe nëpërmjet celularit të tij nga Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Juridike pranë KLGJ-së. Për këtë komunikim është mbajtur edhe procesverbal nga drejtori.

Kam procesverbalin i cili mban nr. {...} prot., datë 01.06.2021, “Procesverbal ‘Mbi bisedën telefonike të kryer me gjyqtarin {...}’” - Ky Procesverbal u mbajt sot, menjëherë pas bisedës telefonike të kryer në datën 26.05.2021, rreth orës 15:50, prej meje {...} me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Shërbimeve Juridike pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Durrës, z. {...}.

Z. {...} ka një numër celulari që e ka referuar në procesverbal dhe z. {...} ka numrin pritës të kësaj bisede.

Në fillim të komunikimit me z. {...}, pas konfirmimit se po flisja me të, (pasi sqarohet se është pyetur nga magjistrati se kush është personi që po bën këtë telefonatë) jam prezantuar se cili isha unë si telefonues dhe funksionin që kam. Më pas kam vijuar duke shpjeguar që në drejtim të postës tij elektronike, KLGJ ka nisur e-mail-in lidhur me qëndrimin e Këshillit, për shtyrjen e datës së zhvillimit të seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj z. {...}, për në datë 02.06.2021, ora 11:00.

Zoti {...} shpjegoi përafërsisht se: Mora dijani për zhvillimin e seancës dëgjimore por unë nuk do ta ndjek këtë procedim disiplinor. E di vendimin që do të merret ndaj meje; Nuk do të marr pjesë; Garantoj se nuk do ta ankimoj vendimin e marrë;

Kërkesës time për t’i kthyer përgjigje e-mail-it të dërguar nga ne, datë 26.05.2021, ora 3:34 PM, iu përgjigj se: “Nuk do t’i përgjigjem, nuk dua të lë gjurmë”.

Ky procesverbal besoj do t’ju vihet ose ju është vënë në dispozicion nga administrata. Është firmosur nga zoti {...}, i shoqëruar së bashku me përmbajtjen e e-mail-it që ne e kemi dërguar pas dira herë të përsëritur.

Kështu që jemi tashmë në situatën që Këshilli do të çmojë dhe të procedojmë më tej në lidhje me....

Zoti Metani, nëse keni gjë për të thënë në lidhje me sa parashtrova, fjala për ju.

**Artur Metani:** Jo! –s’kam.

**Maksim Qoku:** Faleminderit!

Atëherë, anëtarët?

Po, zoti Bici!

**Medi Bici:** Përveç mënyrës së njoftimit që citove, në seancën e kaluar Këshilli vendosi që njoftimi të bëhet edhe në bazë të dispozitave të Kodit të Procedurave Penale, me shpallje. Edhe ky detyrim ligjor është zbatuar, pra është bërë shpallja nga administrata. Kështu që për mendimin tim njoftimet janë të plota, ai ka shprehur vullnetin dhe kërkoj që të vazhdojë seanca dëgjimore.

**Maksim Qoku:** Zoti Hallunaj!

**Dritan Hallunaj:** Faleminderit!

Për sa i përket njoftimit apo marrjes dijeni të subjektit të procedimit, në seancën e shkuar dëgjimore erdhëm në dijeni që ai kishte marrë të njëjtin njoftim dhe kishte konfirmuar të njëjtin njoftim, por përsëri Këshilli, në kuadër të një procesi të rregullt ligjor, votuam që t’i jepnim edhe një herë mundësi, t’i komunikojmë, të njëjtit magjistrati me të gjitha të drejtat dhe detyrimet e tij. Në këtë kuadër, ai u njoftua edhe një herë dhe u shty seanca dëgjimore për datën e sotme, për qëllimin e vetëm, që ai të njoftohej, të merrte dijeni dhe në këto kushte, pas asaj që tha edhe kryetari i Komisionit, zoti Bici, që është bërë edhe shpallje nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, vendosur në seancën e shkuar. Njoftimi i dytë, ajo që ju relatuat, për mendimin tim njoftimi është i plotë, është i saktë dhe subjekti i procedimit ka dijeni për ditën, orën dhe vendin e seancës dëgjimore. Në këto kushte, duke zbatuar, aq sa mundemi për rregullat procedurale të Kodit të Procedurës Penale, unë çmoj që procedimin disiplinor ta zhvillojmë në mungesë të magjistratit {...} dhe të vijojë seanca dëgjimore me hapat e tjera. Faleminderit!

**Maksim Qoku:** Faleminderit zoti Hallunaj!  
Tjetër kush nga anëtarët?  
Atëherë, bazuar në nenin 36 të Rregullores dhe neni 142 të ligjit nr. 96, kalojmë në parashtrimet e palëve?

Fillimisht, kalojmë në votim propozimin e zotit Hallunaj.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Maksim Qoku:** Dakord.

Ky procedim disiplinor do të vazhdojë në mungesë.

Për të vazhduar më tej, kalojmë në parashtrimet e palëve.

Fjala për ju zoti Metani.

**Artur Metani:** Faleminderit!

Të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor!

Në analizë të dokumentacionit të administruar në kuadër të këtij procesi hetimor disiplinor, rezulton e provuar se magjistrati {...} subjekt hetimi disiplinor, me vendimin gjyqësor nr. 69, datë 29.10.2019, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale “Korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuara nga nenet 319/ç dhe 25 të K.Penal.

Nga përmbajtja e vendimit gjyqësor të formës së prerë, rezulton se magjistrati {...} i Gjykatës së Apelit Durrës, është gjetur fajtor për veprime të cilat për nga natyra e

tyre janë të shkallës më të rëndë sikundërse janë aktet korruptive të lidhura me ushtrimin e funksionit të gjyqtarit.

Në mbështetje të nenit 101, pika 1, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, magjistrati kryen shkelje disiplinore, me dashje ose për shkak të pakujdesisë, kur: (a) kryen veprime ose mosveprime, të cilat përbëjnë mospërbushje të detyrës, sjellje joprofesionale ose joetike gjatë ushtrimit të funksionit ose jashtë tij, të cilat diskreditojnë pozitën dhe figurën e magjistratit, ose dëmtojnë besimin e publikut në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë...”.

Në të njëjtën kohë, në analizë të nenit 104 të ligjit nr. 96/2016, i cili parashikon shkeljet disiplinore për shkak të kryerjes së një veprë penale nga ana e magjistratit rezulton se: 1. Shkelje disiplinore për shkak të kryerjes së veprës penale janë veprimet, mosveprimet ose sjelljet, për të cilat magjistrati është dënuar me vendim të formës së prerë... 3. Masa disiplinore e shkarkimit nga detyra jepet vetëm nëse dënimi me vendim të formës së prerë është dhënë për kryerjen e një krimi. Në këtë rast, gjatë procedurës disiplinore, parashikimet e këtij ligji zbatohen për aq sa është e nevojshme.”

Vepra penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, për të cilën është gjetur fajtor dhe është dënuar gjyqtari {...} parashikohet si krim nga neni 319/ç të K.Penal. Nga ana tjetër, rezulton se në rastin konkret janë plotësuar në mënyrë kumulative dy kushtet e parashikuara nga neni 104, pika 3, të Ligjit Nr. 96/2016 ku parashikohet se: (a) gjyqtari të jetë dënuar për kryerjen e një krimi dhe (b) vendimi i dënimit të jetë i formës së prerë.

Në raport me faktet e provuara në këtë proces hetimi disiplinor si dhe të pranuar nga gjykata rezulton se nga ana e magjistratit {...} janë ndërmarrë veprime aktive me anë të përfitimit në mënyrë të drejtpërdrejtë, veprime të cilat janë vlerësuar se përmbajnë elementë të veprës penale të parashikuar nga neni 319/ç i K.Penal, të kryera gjatë ushtrimit të detyrës dhe me qëllim përfitim të parregullt prej tyre, duke favorizuar njërin palë ndërgjyqëse nëpërmjet dhënies së vendimi gjyqësor civil në favor të tij.

Në analizë të kriterit “shkalla e fajësisë dhe motivi”, referuar fakteve dhe rrethanave të pranuar nga gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit në vendimet e tyre respektivisht me nr. {...} datë 29.10.2019 dhe nr. {...} datë 21.09.2020, rezulton se vepra

penale është kryer me dashje direkte, e cila është dhe forma më e lartë e fajit në kryerjen e veprës penale, me motiv kryesor përfitimin drejtpërdrejt dhe të parregullt përkundrejt dhënies së një vendimi civil në favor të një pale të paditur në proces gjykimi civil në Gjykatën e Apelit Durrës nga gjyqtari {...}.

Veprimet e magjistratit {...} kanë cenuar veprimtarinë e rregullt të organeve të drejtësisë nga veprimet e parregullta të personave të jashtëm por edhe nga veprimet e vetë atyre si funksionarë të drejtësisë.

Këto veprime kanë cenuar besimin e palëve ndërgjyqëse dhe të publikut në organet e drejtësisë dhe respektimin e ligjit nga ana tyre, si dhe kanë diskretitur rëndë pozitën dhe figurën e magjistratit.

Ushtrimi i pa rregullt i detyrës nga ana e magjistratit {...} ka sjellë pasoja për dhënien e drejtësisë, ka diskretitur rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit, si dhe ka cenuar besimin e publikut te drejtësia.

Në nenin 3, pika 5, të ligjit nr. 96/2016 është parashikuar se sjellja e magjistratit është e lidhur me garantimin e ruajtjes e forcimit të besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë. Nëse magjistratët nuk e përmbushin plotësisht rolin e tyre për dhënien e sigurimin e drejtësisë në shoqëri, ekziston rreziku i humbjes së besimit të publikut në sistemin e drejtësisë. Besimi i publikut dhe respekti për gjyqësorin janë garanci të demokracisë dhe stabilitetit në një shoqëri demokratike. Për rrjedhojë vlerësohet se shkelja disiplinore për shkak të dënimit për kryerjen e një krimi që lidhet me ushtrimin e detyrës është e natyrës së tillë që e bën të padenjë të vazhdojë detyrën e gjyqtarit.

Kjo masë disiplinore përcaktohet pikësëpari në nenin 140, pika 2, të Kushtetutës, sipas të cilit gjyqtari shkarkohet nga detyra kur: (a) kryen shkelje të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e tij gjatë ushtrimit të detyrës; si dhe kur (b) është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi.

Në të njëjtën kohë kjo masë parashikohet edhe në nenin 111, pika 1, shkronja “b” të Ligjit nr. 96/2016, ku parashikohet përgjegjësia disiplinore e magjistratit për një shkelje shumë të rëndë, që e bën atë të papërshtatshëm ose të padenjë për të vazhduar ushtrimin e funksionit. Papërshtatshmëria ose padenjësia e magjistratit për të vazhduar funksionin mund të ketë si shkak: (i) dënimin e magjistratit për kryerjen e një krimi; (ii)



paaftësinë e rëndë dhe dukshme të magjistratit; ose (iii) sjellje të kryer me pakujdesi të rëndë, që shkel haptazi vlerat themelore të sistemit gjyqësor.

Për sa më sipër, nga analiza ligjore e fakteve të konstatuara, duke mbajtur në konsideratë: (i) natyrën e shkeljes disiplinore, ajo e kryerjes së një krimi për të cilin është dënuar me vendim të formës së prerë, të parashikuar nga neni 140, pika 2, shkronja “b” e Kushtetutës dhe neni 104 i ligjit nr. 96/2016; (ii) faktin që shkelja disiplinore në rastin konkret përbën “Shkelje shumë të rëndë disiplinore”; në rastin konkret provohet se magjistrati {...} ka diskretituar pozitën dhe figurën e magjistratit, ka cenuar rëndë imazhin e drejtësisë dhe ka ulur besimin e publikut tek dhënia e drejtësisë.

Duke mbajtur në konsideratë faktin se masa disiplinore është e varur nga ekzistenca e përgjegjësisë disiplinore së magjistratit, në përputhje me parimin e ligjshmërisë, duke u siguruar që masa e dhënë të jetë e parashikuar nga ligji dhe e nevojshme për të përmbushur qëllimin e ligjit; duke u bazuar në kriteret objektive lidhur me rëndësinë e shkeljes disiplinore dhe masës disiplinore; individualizmit dhe proporcionalitetit, pra që ndaj magjistratit të jepet ajo masë që është e domosdoshme dhe e dobishme, për arritjen e qëllimit të procedimit disiplinor ndaj tij, në përputhje me shkeljen disiplinore që ka kryer, vlerësohet se për shkeljen disiplinore të kryer nga magjistrati {...}, duhet të jepet masa “Shkarkim nga detyra”, parashikuar nga neni 140, pika 2, shkronja “b” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 104, pika 3 dhe 111, pika 1, shkronja “b” të ligjit nr. 96/2016.

Ndërkohë vlen të theksohet gjithashtu se në rastin kur shkelja disiplinore identifikohet me kryerjen e një krimi, për të cilin magjistrati është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, referuar nenit 140, pika 2, shkronja “b” të Kushtetutës së si dhe nenit 111, pika 1, shkronja “b” të ligjit nr. 96/2016 passjell shkarkimin nga detyra të magjistratit, si një masë me natyrë përjashtuese nga sistemi gjyqësor, me karakter të përhershëm e cila nuk shuhet, referuar parashikimeve të nenit 150, pika 3, të ligjit nr. 96/2016.

Për sa më sipër, kërkojmë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor të administrojë provat e paraqitura nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në këtë procedim disiplinor dhe në

mbështetje të nenit 105, pika 1, shkronja “dh”; nenit 111, pika 1, shkronja “b”, dhe nenit 146, pika 2, shkronja “b”, të Ligjit nr. 96/2016, të vendosë:

Pranimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Durrës për shkeljet disiplinore të parashikuara nga neni 140, pika 2, shkronja “b” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nga neni 104, pika 3, dhe neni 111, pika 1, shkronja “b” e Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe caktimin ndaj tij të masës disiplinore “Shkarkim nga detyra”.

**Maksim Qoku:** Faleminderit zoti Metani!

Atëherë, sikurse magjistrati është në mungesë dhe Këshilli vendosi vazhdimin e procedimit në mungesë, kalojmë në administrimin e provave.

Zoti Metani, përveçse për sa parashtruat, keni prova të tjera?

**Artur Metani:** Jo!

Vetëm ato që kam dorëzuar.

**Maksim Qoku:** Atëherë, bazuar në nenin 36 të Rregullores, pika dh) Këshilli kalon në administrimin e provave dhe mbylljen e parashtrimit të fakteve nga palët (faza e shqyrtimit).

Nëse relatori nuk ka gjë për të shtuar, kalojmë në parashtrimin e konkluzioneve?  
Zoti Metani, i keni gati?

**Artur Metani:** Po!

**Maksim Qoku:** Atëherë fjala për ju.

**Artur Metani:** Unë e kam përgatitur edhe me shkrim në mënyrë që të mos jetë e lodhshme. Në mënyrë të përmbledhur:

Të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor!

Në analizë të dokumentacionit të administruar në kuadër të këtij procesi disiplinor, rezultoi e provuar se gjyqtari {...} me vendimin gjyqësor nr. {...}, datë 29.10.2019 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 19, datë 21.09.2020 të Gjykatës së Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë, është deklaruar fajtor për veprën penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, të parashikuar nga neni 319/ç të K.Penal.

Në rast se kjo rezulton e provuar se janë plotësuar dy kushtet e parashikuara nga neni 104, pika 3 e ligjit 96/2016 dhe konkretisht gjyqtari të jetë dënuar për kryerjen e një krimi dhe vendimi i dënimit të jetë i formës së prerë. Rezulton se vendimi i Gjykatës së Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar nr. {...}, datë 21.09.2020, me të cilin është dënuar gjyqtari {...} për kryerjen e një krimi të parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal, konsiderohet vendim i formës së prerë, referuar parashikimeve të nenit 462, pika 3, shkronja “b” dhe neni 428, pika 1, shkronja “a” dhe “b” të Kodit të Procedurës penale.

Që të mos përsëris gjëra që u thanë në parashtresën fillestare, në përfundim të këtij procedimi, kërkoj nga Këshilli i Lartë Gjyqësor të administrojë provat e paraqitura nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për këtë procedim dhe në mbështetje të nenit 105, pika 1, shkronja “dh” dhe nenit 111, pika 1, shkronja “b” dhe nenit 146, pika 2, shkronja “b” e ligjit 96/2016 të vendosë:

Pranimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Durrës për shkeljet disiplinore të parashikuara nga neni 140, pika 2, shkronja “b” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nga neni 104, pika 3, dhe neni 111, pika 1, shkronja “b” e Ligjit nr. 96/2016 dhe caktimin ndaj tij të masës disiplinore “Shkarkim nga detyra”.

Po i depozitoj.

*Maksim Qoku:* Faleminderit zoti Metani!

Atëherë, zoti Metani ju mund të dilni jashtë që Këshilli të procedojë në lidhje me debatin.

*(Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. Artur Metani largohet nga salla e mbledhjes. Më tej shqyrtimi i çështjes vijon vetëm në prezencë të anëtarëve, deri në momentin kur ILD futet në sallë për të marrë dijëni rreth vendimmarrjes së Këshillit.)*

**Maksim Qoku:** Atëherë, në përfundim të diskutimeve të anëtarëve dhe votimit që u zhvillua në lidhje me çështjen, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi:

1. Pranimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
2. Shkarkimin nga detyra të magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Durrës.
3. Ndërprerjen e menjëhershme të marrëdhënieve financiare dhe konkretisht të pagës dhe përfitimeve të tjera të magjistratit {...}.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim sipas ligjit në Kolegjin e Posaçëm të Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese, afat i cili vazhdon nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
5. Një kopje e vendimit i njoftohet subjekteve të procedimit disiplinor, magjistratit {...} dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Me kaq e deklaroj të mbyllur këtë shqyrtim.

Faleminderit!

\*Çështjet e tjera të rendit të ditës vijojnë nëpërmjet platformës “online”.

\* \* \*

(Pika 2 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 02.06.2021)*

**Pika 3 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësisht nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës dhe Gjykatën e Apelit Korçë për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 129 dhe nr. 132, datë 01.05.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).<sup>2</sup>

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:50 dhe mbaroi në orën 15:11.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Naureda Llagami</b> | <b>(kryetare)</b>        |
| <b>2. Maksim Qoku</b>     | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>3. Medi Bici</b>       | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>4. Fatmira Luli</b>    | <b>(anëtare)</b>         |

<sup>2</sup> Sipas rendit të ditës kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e dyta.

5. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
6. *Brunilda Kadi* (anëtare)
7. *Illir Toska* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
10. *Marçela Shehu* (anëtare)
11. *Erjon Muharremaj* (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
4. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
5. *Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
6. *Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës dhe Gjykatën e Apelit Korçë për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 129 dhe nr. 132, datë 01.05.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

*Naureda Llagami:* Kalojmë në çështjen e dytë e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës dhe Gjykatën e Apelit Korçë. Për më shumë detaje, fjalën po ia jap relatorit z. Alban Toro.

*Alban Toro:* Faleminderit!

Në kushtet kur relacioni është dërguar pranë jush, po e paraqes në mënyrë të sintetizuar.

Me dy vendime të veçanta, atë me nr. 129 dhe 132, 01.04.2021, nga ana e Këshillit kanë filluar procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Durrës dhe Korçë dhe përkatësisht në fushën e të drejtës penale. Një nga këto kandidatë ka qenë edhe zoti {...}, i cili aktualisht është gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, por që operon në skemë delegimi dhe është komanduar në Gjykatën e Apelit Korë.

Me fillimin e procedurës së verifikimit, sipas vendimit nr. 180, 29.04.2021 të Këshillit nga ana ime është proceduar për administrimin e dokumentacionit të nevojshëm i cili do të provojë plotësimin e kriterëve në përputhje me nenin 8/3, 47/4, 48/8 të ligjit për Statusin.

Nga të dhënat e administruara gjatë verifikimit rezulton se z. {...} të ketë mbi 7 vjet përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtar i gjykatës së shkallës së parë dhe si gjyqtar i komanduar përkohësisht. Gjithashtu, nga këto të dhëna rezulton që magjistrati, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë rezulton të ketë mbi 5 vjet përvojë profesionale në fushën e të drejtës penale.

Nga Burimet Njerëzore konfirmohet se nuk ka masë disiplinore në fuqi për të. Gjithashtu nga dokumentacioni i administruar për kandidatin {...}, nuk vërtetohet që ai të ndodhet në një situatë papajtueshmërie ambientale në rast të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës apo në Gjykatën e Apelit Korçë. Kështu që, me administrimin e këtyre akteve, i është kaluar për miratim procedura Komisionit i cili ka vendosur t'ia kalojë Këshillit duke përgatitur edhe projekt-aktin përkatës, i cili sugjerohet ta miratoni. Në dispozitiv do të gjeni:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës dhe Gjykatën e Apelit Korçë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me Vendimet nr. 129 dhe nr. 132, datë 01.04.2021, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës dhe Gjykatën e Apelit Korçë, për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës penale me Vendimet nr. 129 dhe nr. 132, datë 01.04.2021.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit!

Kemi ndonjë diskutim mbi përmbajtjen?

Nëse jo, kalojmë në votimin e saj?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Illir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e projektvendimit “Për verifikimin e plotësisimit nga kandidati z. {...} të tre kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës dhe Gjykatën e Apelit Korçë për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 129 dhe nr. 132, datë 01.05.2021, të



Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, sipas propozimit të ardhur nga relatori.

\* \* \*

(Pika 3 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

***PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 02.06.2021)*

***Pika 4 e rendit të ditës me objekt:*** Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 129, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).<sup>3</sup>

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:50 dhe mbaroi në orën 15:11.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
- 3. Medi Bici*** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 5. Dritan Hallunaj*** (anëtar)

<sup>3</sup> Sipas rendit të ditës kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e treta.

- |                             |                  |
|-----------------------------|------------------|
| <i>6. Brunilda Kadi</i>     | <i>(anëtare)</i> |
| <i>7. Ilir Toska</i>        | <i>(anëtar)</i>  |
| <i>8. Alban Toro</i>        | <i>(anëtar)</i>  |
| <i>9. Brikena Ukperaj</i>   | <i>(anëtare)</i> |
| <i>10. Marçela Shehu</i>    | <i>(anëtare)</i> |
| <i>11. Erjon Muharremaj</i> | <i>(anëtar)</i>  |

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 5. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
- 6. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 129, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

*Naureda Llagami:* Kalojmë në projekt-aktin tjetër i cili ka të bëjë me verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale. Edhe për këtë projekt-akt, relator është z. Toro.

*Alban Toro:* Faleminderit!

Edhe zonja {...} është gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat dhe aktualisht është transferuar me pëlqim përkohësisht pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë. Është një nga konkurrentet për procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Durrës për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 129, datë 01.04.2021.

Në kuadër të verifikimit të kriterëve të kandidimit edhe për këtë magjistratë janë administruar aktet e nevojshme në përputhje me nenin 8/3, 47/4 dhe 48/8 të ligjit për Statusin. Nga analiza e këtyre akteve ka rezultuar që magjistratja {...} rezulton të ketë mbi 7 vjet përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtare e shkallës së parë dhe si gjyqtare e komanduar. Gjithashtu ajo rezulton të ketë mbi 5 vjet përvojë profesionale në fushën e së drejtës penale.

Nga Burimet Njerëzore konfirmohet që nuk ka një masë disiplinore në fuqi për të.

Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit për kandidaten Goxha, nuk vërtetohet që të ndodhet në një situatë papajtueshmërie ambientale në rast të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës.

Kështu që pasi u kalua në Komision, ky i fundit e miratoi dhe ia kaloi për shqyrtim Këshillit, duke përgatitur edhe projektin bashkëngjitur, në dispozitivin e të cilit ju do të gjeni:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin nr. 129, datë 01.04.2021, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatës së Apelit Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin nr. 129, datë 01.04.2021.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

*Naureda Llagami:* Faleminderit!

Kemi ndonjë diskutim?

Nëse jo, kalojmë në votim?

*Maksim Qoku:* Dakord.

*Brunilda Kadi:* Dakord.

*Dritan Hallunaj:* Pro.

*Illir Toska:* Dakord.

*Alban Toro:* Dakord.

*Fatmira Luli:* Dakord.

*Marçela Shehu:* Dakord.

*Erjon Muharremaj:* Pro.

*Brikena Ukperaj:* Pro.

*Medi Bici:* Pro.

*Naureda Llagami:* Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 129, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, sipas propozimit që ka bërë Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

\* \* \*

(Pika 4 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 02.06.2021)*

**Pika 5 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 129, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).<sup>4</sup>

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:50 dhe mbaroi në orën 15:11.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)

<sup>4</sup> Sipas rendit të ditës kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e katërta.

- |                             |                  |
|-----------------------------|------------------|
| <b>6. Brunilda Kadi</b>     | <b>(anëtare)</b> |
| <b>7. Ilir Toska</b>        | <b>(anëtar)</b>  |
| <b>8. Alban Toro</b>        | <b>(anëtar)</b>  |
| <b>9. Brikena Ukperaj</b>   | <b>(anëtare)</b> |
| <b>10. Marçela Shehu</b>    | <b>(anëtare)</b> |
| <b>11. Erjon Muharremaj</b> | <b>(anëtar)</b>  |

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 4. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 5. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.**
- 6. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.**

#### **RENDI I DITËS:**

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 129, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

**Naureda Llagami:** Kalojmë tek çështja tjetër që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 129, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore. Edhe për këtë relator do jetë z. Toro.

***Alban Toro:*** Faleminderit!

Edhe zonja {...}, e komanduar aktualisht në detyrën e nëpunësit përgjegjës në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të gjyqtarëve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, është një nga kandidatet e cila konkurren në procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Durrës për një pozicion të lirë në fushën e së drejtës penale, konform vendimit nr. 129, 01.04.2021.

Nga ana e relatorit janë administruar aktet të cilat do të konfirmonin plotësimin e kriterëve në përputhje me nenet 8/3, 47/4, 48/8 të ligjit për Statusin.

Gjithashtu, Këshilli me shkresën nr. {...} prot., 06.05.2021, i ka kërkuar Komisionit të Pavarur të Kualifikimit trajtimin me përparësi të procedurës së rivlerësimit kalimtar ndaj kandidatës, pasi ajo është subjekt rivlerësimi ex officio sipas ligjit 84/2016.

Për këtë kandidate është administruar dhe analizuar dokumentacioni i nevojshëm nga i cili rezulton që ajo ka mbi 7 vjet përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtare e gjykatës së shkallës së parë dhe si gjyqtare e komanduar. Në lidhje me përvojën specifike profesionale kandidatja ka deklaruar se ka ushtruar detyrën e gjyqtarës në seksionin penal dhe më pak në seksionin civil pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër për një periudhë 9-vjeçare. Gjithashtu, si përvojë e saj është marrë/vlerësuar edhe ajo si inspektore pranë ish-Inspektoratit të KLD-së, e cila për efekt të përvojës specifike profesionale është një eksperiencë në fushën e së drejtës penale. Pavarësisht se në asnjë dispozitë ligjore kjo gjë nuk thuhet në mënyrë të shprehur, kjo konkludohet nga natyra e punës që kjo kandidate ka pasur në kuadër të kryerjes së inspektimeve. Referuar nenit 1 të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, objekt i veprimtarisë së Inspektoratit ishte: Mbledhja e të dhënave rreth veprimtarisë së gjykatave dhe gjyqtarëve, nëpërmjet verifikimit të ankesave, inspektimit të gjykatave, inspektimit të gjyqtarëve dhe vlerësimit të aftësive të tyre profesionale, mbi të cilat ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë zhvillon përgjegjësitë ligjore të tij. Natyrisht, gjatë kuadrit të punës së saj do të konstatonte ekzistencën e shkeljeve disiplinore apo të rasteve të shkarkimit të gjyqtarëve dhe dokumentimi i tyre, nëpërmjet verifikimeve dhe inspektimeve, mbi të cilat nga autoriteti përgjegjës mund të fillonte procedimi disiplinor.



Gjithashtu, në përputhje me pikën 2 të nenit 47 të ligjit 96/2016 ku përcaktohet se: “ a) për pozicionin gjyqtar në gjykatën e posaçme të shkallës së parë për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, magjistrati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet si gjyqtar, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar në fushën e drejtësisë kriminale ose si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar; b) për pozicionin gjyqtar apeli në Gjykatën e Posaçme të Apelit për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, magjistrati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se dhjetë vjet si gjyqtar, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale ose si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;...”, nga interpretimi sistematik i dispozitave, rezulton se puna si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë konsiderohet përvojë specifike profesionale në fushën e të drejtës penale. Për rrjedhojë, edhe puna e kandidatës si inspektore pranë Inspektoratit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ku fusha e veprimtarisë është pothuaj e njëjtë me atë që ka sot Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është konsideruar si përvojë specifike profesionale në fushën e të drejtës penale. Pra nga të dhënat rezulton se ajo ka mbi 5 vjet përvojë profesionale në fushën e së drejtës penale.

Gjithashtu nga Burimet Njerëzore është konfirmuar fakti që nuk vërtetohet që kandidatja {...} të ketë masë disiplinore në fuqi.

Gjithashtu nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit për këtë kandidatë nuk vërtetohet që të ndodhet në situatë papajtueshmërie ambientale në rastin e ngritjes në detyrë në gjykatën e apelit.

Pasi Komisioni miratoi procedurën përkatëse, iu kalua për shqyrtim Këshillit, duke i bashkëngjitur edhe projektvendimin, në dispozitivin e të cilit do të gjeni:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin nr. 129, datë 01.04.2021, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatës së Apelit Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin nr. 129, datë 01.04.2021.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidaten znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toro!

Kalojmë në votim, nëse s’keni ndonjë diskutim?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 129, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, sipas propozimit që ka sjellë Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

\* \* \*

(Pika 5 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 02.06.2021)*

**Pika 6 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të katër kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 125, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska).<sup>5</sup>

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:50 dhe mbaroi në orën 15:11.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
- 3. Medi Bici*** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 5. Dritan Hallunaj*** (anëtar)

<sup>5</sup> Sipas rendit të ditës kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e pesta.

- |                             |                  |
|-----------------------------|------------------|
| <b>6. Brunilda Kadi</b>     | <b>(anëtare)</b> |
| <b>7. Ilir Toska</b>        | <b>(anëtar)</b>  |
| <b>8. Alban Toro</b>        | <b>(anëtar)</b>  |
| <b>9. Brikena Ukperaj</b>   | <b>(anëtare)</b> |
| <b>10. Marçela Shehu</b>    | <b>(anëtare)</b> |
| <b>11. Erjon Muharremaj</b> | <b>(anëtar)</b>  |

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 4. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 5. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.**
- 6. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.**

#### **RENDI I DITËS:**

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të katër kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 125, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska).

**Naureda Llagami:** Kalojmë në projekt-aktin e radhës që edhe kjo ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të katër kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë të shpallur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Për më shumë detaje fjalën ia jap zotit Toska.

**Ilir Toska:** Faleminderit!

Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 125, datë 01.04.2021 ka rihapur procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për një pozicion të lirë. Brenda afatit të kandidimit, që ka përfunduar më datë 16 prill 2021, ka kandiduar gjyqtarja znj. {...} që është me caktim të përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, ndërsa aktualisht është e komanduar si Këshilltare Ligjore pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me Vendimin nr. 179, datë 29.04.2021, Këshilli ka vendosur: Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, përfshirë edhe për pozicionin e shpallur me Vendimin nr. 125, datë 01.04.2021, ku si relator për kandidaten znj. {...} jam caktuar unë.

Mbas caktimit si relator kam grumbulluar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm sipas përcaktimeve të bëra në vendimin e Këshillit nr. 75 të vitit 2019, duke njoftuar rregullisht edhe kandidaten sa i përket caktimit të relatorit dhe të drejtës që ajo ka për të kërkuar përjashtimin e tij apo të çdo anëtari të Këshillit. Nuk ka pasur pretendime nga ana e kandidates. Ndërkohë që, referuar dokumentacionit dhe në zbatim të vendimit të Këshillit nr. 125, me qëllim për të vijuar edhe me procesin e vlerësimit etik dhe profesional për kandidatët që plotësojnë kriteret formale të kandidimit sa i përket procedurave të ngritjes në detyrë, është plotësuar i gjithë dokumentacioni sa i përket katër kriterëve formale të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sa i përket kandidaten {...}. Konkretisht është verifikuar kriteri i pasjes së “përvojës profesionale minimale”. Për këtë është administruar dokumentacioni nga Departamenti i Burimeve Njerëzore pranë Këshillit, rezulton se kandidatja {...} të ketë filluar detyrën e gjyqtarit sipas Dekretit të Presidentit të Republikës të datës 21.10.2013, ku është emëruar për të kryer stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Më pas, me Dekretin e Presidentit të Republikës të datës 25.09.2015, ajo është emëruar përfundimisht gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë. Aktualisht, sipas vendimit të Këshillit nr. 207, datë 11.10.2019, znj. {...} ushtron funksionin e Këshilltares Ligjore pranë Njesisë Mbështetëse të Komisioneve në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Nga dokumentacioni i administruar rezulton se znj. {...} të përmbushë kriterin e përvojës profesionale minimale të përcaktuar në nenin 47 të ligjit për Statusin, pra të ketë më shumë se 7 vjet si gjyqtare në gjykatën e shkallës së parë dhe si gjyqtare e komanduar.

Nga ana tjetër, po ashtu rezulton, referuar dokumentacionit të grumbulluar nga ana e gjykatave ku zonja {...} ka ushtruar funksionin e gjyqtares (Gjykata Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë), që të plotësojë edhe kriterin tjetër që i përket po pjesë e kriterit të përvojës minimale profesionale, atë të përvojës specifike në fushën e së drejtës për të cilin ajo konkurron, që është në të drejtën penale.

Po ashtu, për zonjën {...} është verifikuar edhe kriteri për dhënien e pëlqimit ajo dhe familjarët e afërt për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe telekomunikimeve vetjake sipas ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, këtë gjë zonja {...} bashkë me bashkëshortin e ka bërë duke plotësuar deklaratën, sipas formularëve të miratuar përmes ligjit të sipërpërmendur dhe depozituar ajo në momentin e kandidimit.

Po ashtu për kandidaten është verifikuar edhe kriteri i mospasjes masë disiplinore në fuqi. Për këtë është marrë informacion nga Departamenti i Burimeve Njerëzore pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor ku rezulton se nuk ka masë disiplinore, përveçse një gjë e tillë është deklaruar edhe nga vetë kandidatja përmes formularit përkatës në momentin e kandidimit.

Së fundi, për kandidaten është verifikuar edhe kriteri i papajtueshmërisë ambientale. Për këtë nga kandidatja është plotësuar formulari përkatës ku deklaron se nuk do të ndodhet në kushtet e papajtueshmërisë ambientale nëse ngrihet në detyrë në pozicionin ku ka kandiduar. Ndërkohë që gjatë verifikimit nuk rezultoi ndonjë e dhënë tjetër, e ndryshme nga sa kandidatja ka deklaruar.

Mbi sa më lart, të gjithë procedurën e ndjekur ia kam përcjellë Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, i cili ka vendosur që kjo procedurë është e plotë dhe ka vendosur që çështja t’i kalojë për shqyrtim Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në këto kushte, në cilësinë e relatorit, i propozoj Këshillit që të vendosë:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 125, datë 01.04.2021, të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “dhënies së pëlqimit (ajo edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 125, datë 01.04.2021.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatës znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toska!

Kemi ndonjë diskutim mbi projekt-aktin?

Nëse jo, kalojmë në votimin e tij sipas propozimit?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.



***Brikena Ukperaj***: Pro.

***Medi Bici***: Pro.

***Naureda Llagami***: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të katër kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 125, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

\* \* \*

(Pika 6 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

***PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 02.06.2021)*

***Pika 7 e rendit të ditës me objekt:*** Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të katër kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 117, nr. 118 dhe nr. 119, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska).<sup>6</sup>

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:50 dhe mbaroi në orën 15:11.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                                  |                                 |
|----------------------------------|---------------------------------|
| <b><i>1. Naureda Llagami</i></b> | <b><i>(kryetare)</i></b>        |
| <b><i>2. Maksim Qoku</i></b>     | <b><i>(zëvendëskryetar)</i></b> |
| <b><i>3. Medi Bici</i></b>       | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b><i>4. Fatmira Luli</i></b>    | <b><i>(anëtare)</i></b>         |

<sup>6</sup> Sipas rendit të ditës kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e gjashta.

- |                             |                  |
|-----------------------------|------------------|
| 5. <i>Dritan Hallunaj</i>   | <i>(anëtar)</i>  |
| 6. <i>Brunilda Kadi</i>     | <i>(anëtare)</i> |
| 7. <i>Illir Toska</i>       | <i>(anëtar)</i>  |
| 8. <i>Alban Toro</i>        | <i>(anëtar)</i>  |
| 9. <i>Brikena Ukperaj</i>   | <i>(anëtare)</i> |
| 10. <i>Marçela Shehu</i>    | <i>(anëtare)</i> |
| 11. <i>Erjon Muharremaj</i> | <i>(anëtar)</i>  |

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
4. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
5. *Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
6. *Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të katër kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 117, nr. 118 dhe nr. 119, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Illir Toska).

*Naureda Llagami:* Kalojmë tek pika e shtatë që ka të bëjë edhe kjo me verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të katër kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Për më shumë detaje, prapë fjalën ia jap zotit Toska.

***Ilir Toska:*** Faleminderit!

Atëherë, Këshilli i Lartë Gjyqësor në datën 1 prill 2021 ka hapur 3 procedura ngritjeje në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin ne Krimin e Organizuar, respektivisht me vendimet nr. 117, nr. 118 dhe nr. 119. Në këto procedura ngritjeje në detyrë, brenda afatit të kandidimit që ka përfunduar më datë 16 prill 2021 ka kandiduar edhe zonja {...} e cila është gjyqtare me caktim të përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndërsa aktualisht është e komanduar si pedagoge e brendshme pranë Shkollës së Magjistraturës.

Me vendimin nr. 178, datë 29 prill 2021 Këshilli ka filluar procedurën e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit edhe sa i përket kandidatëve për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ku mbas shortit të hedhur, si relator për verifikimin e plotësimit të kriterëve nga kandidatja zonja {...}, jam caktuar unë.

Në këtë funksion kam njoftuar kandidaten për të drejtën që ka për të kërkuar përjashtimi tim apo të çdo anëtari të Këshillit. Ka konfirmuar marrjen e njoftimit dhe nuk ka paraqitur kundërshtime.

Nga ana tjetër, në cilësinë e relatorit kam grumbulluar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm sa i përket verifikimit të katër kriterëve formale të kandidimit, me qëllim që Këshilli të mund të procedojë më tej në rast të plotësimit të këtyre kriterëve, për vlerësimin etik dhe profesional të kandidatëve, një nga kërkesat e ligjit sa i përket ngritjes në detyrë në gjykatat e posaçme.

Sa i përket katër kriterëve formale të kandidimit është kërkuar dokumentacion nga Departamenti i Burimeve Njerëzore pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor. Ka rezultuar se kandidatja {...} plotëson kriterin e përvojës profesionale minimale të përcaktuar në nenin 47, pika 2, shkronja “b”, të Ligjit për Statusin. Rezulton që zonja {...} të ketë filluar detyrën e gjyqtarit sipas Dekretit të Presidentit të Republikës të datës 21.10.2003, nëpërmjet të cilit është emëruar për të kryer stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, ndërsa me Dekretin e Presidentit të Republikës të datës 16.09.2004 ajo është emëruar përfundimisht gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan. Më pas, me Vendimin e datës 20.12.2013, të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ajo është

transferuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me Vendimin e datës 22.10.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, kandidatja është komanduar për një periudhë 5-vjeçare si pedagoge e brendshme në Shkollën e Magjistraturës, ku vazhdon dhe aktualisht.

Referuar sa më lart, rezulton që kandidatja të përmbushë kriterin e përvojës minimale 10-vjeçare që kërkon ligji për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Po ashtu, sa i përket përvojës specifike profesionale minimale që kërkohet nga ligji (pra 5 vjet në fushën e së drejtës penale) referuar pozicionit të lirë ku ka kandiduar, është marrë informacion nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe ka rezultuar që kandidatja të ketë ushtruar funksionin në fushën e së drejtës penale për më shumë se 5 vjet (referuar informacionit të marrë nga këto gjykata).

Po ashtu për kandidaten {...} është verifikuar kriteri i dhënies së pëlqimit ajo dhe familjarët e afërt, për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, ndërsa në momentin e kandidimit ajo dhe bashkëshorti i saj kanë plotësuar formularët e vetëdeklarimeve sipas kërkesave të ligjit të sipërpërmendur.

Po ashtu, për kandidaten zonjën {...} është verifikuar edhe kriteri i mospasjes masë disiplinore në fuqi. Për këtë është marrë informacion nga Departamenti i Burimeve Njerëzore pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, përveçse kandidatja ka plotësuar edhe një deklaratë në momentin e kandidimit.

Është verifikuar për kandidaten edhe kriteri tjetër formal sa i përket papajtueshmërisë ambientale. Për këtë kandidatja ka deklaruar se nëse do të ngrihej në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, nuk do ndodhej në situatën e papajtueshmërisë ambientale, ndërkohë që gjatë verifikimit nuk rezulton ndonjë e dhënë e ndryshme nga ajo e deklaruar nga kandidatja.

Nisur nga sa më lart, të gjithë procedurën e ndjekur, bashkë me dokumentacionin përkatës ia kam përcjellë Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, i cili e ka konsideruar të

plotë këtë procedurë, duke vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim përpara Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në përfundim, në cilësinë e relatorit, i propozoj Këshillit që të vendosë: 1. Verifikimin e plotësimin nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 117, nr. 118 dhe nr. 119, datë 01.04.2021, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “dhënies së pëlqimit (ajo edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 117, nr. 118 dhe nr. 119, datë 01.04.2021.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatës znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Kemi ndonjë diskutim?

Nëse jo, kalojmë në procedurën e votimit?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

*Erjon Muharremaj*: Pro.

*Brikena Ukperaj*: Pro.

*Medi Bici*: Pro.

*Naureda Llagami*: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të katër kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 117, nr. 118 dhe nr. 119, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, sipas propozimit të ardhur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierë.

\* \* \*

(Pika 7 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 02.06.2021)*

**Pika 8 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës dhe Vlorë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 129, datë 01.04.2021 dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 135, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore znj. Marçela Shehu).<sup>7</sup>

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:50 dhe mbaroi në orën 15:11.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Naureda Llagami</b> | <b>(kryetare)</b>        |
| <b>2. Maksim Qoku</b>     | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>3. Medi Bici</b>       | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>4. Fatmira Luli</b>    | <b>(anëtare)</b>         |

<sup>7</sup> Sipas rendit të ditës kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e shtata.



- |                             |                  |
|-----------------------------|------------------|
| 5. <i>Dritan Hallunaj</i>   | <i>(anëtar)</i>  |
| 6. <i>Brunilda Kadi</i>     | <i>(anëtare)</i> |
| 7. <i>Illir Toska</i>       | <i>(anëtar)</i>  |
| 8. <i>Alban Toro</i>        | <i>(anëtar)</i>  |
| 9. <i>Brikena Ukperaj</i>   | <i>(anëtare)</i> |
| 10. <i>Marçela Shehu</i>    | <i>(anëtare)</i> |
| 11. <i>Erjon Muharremaj</i> | <i>(anëtar)</i>  |

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
4. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
5. *Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
6. *Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

8. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës dhe Vlorë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 129, datë 01.04.2021 dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 135, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore znj. Marçela Shehu).

*Naureda Llagami:* Kalojmë tek çështja e radhës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës dhe Vlorë...”. Për më shumë detaje, fjalën ia jap zonjës Shehu.

*Marçela Shehu:* Faleminderit, Kryetare!

Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin e tij nr. 129, datë 01.04.2021 ka vendosur hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Durrës, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale, ndërsa me vendimin e tij nr. 135, datë 01.04.2021 ka vendosur rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Vlorë për një pozicion të lirë në fushën e së drejtës civile.

Brenda afatit të kandidimit, përcaktuar në këto vendime, ka kandiduar edhe magjistratja zonja {...} e cila aktualisht ushtron funksionin e gjyqtares pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Në vijim, me vendimin nr. 180, datë 29.04.2021 “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 01.04.2021”, Këshilli ka vendosur: Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatat e Apelit Durrës, Korçë dhe Vlorë, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr. 129, nr. 132 dhe nr.135, datë 01.04.2021. Për kandidatën {...}, pas procedurës së shortit unë jam caktuar me cilësinë e relatores.

Ka vijuar procesi i verifikimit të plotësimit nga kandidatja të kriterëve ligjore, siç përcakton ligji, konkretisht verifikime lidhur me kriterin e përvojës profesionale minimale, të mospasjes masë disiplinore në fuqi dhe të mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale.

Nga procedura e verifikimit dhe të dhënat që kanë rezultuar gjatë saj, të cilat në mënyrë të hollësishme janë detajuar në relacionin përkatës që ju e keni në dispozicion, ka rezultuar që kjo candidate i plotëson të tre kriteret që kërkon ligji lidhur me kandidimin në procedurat e ngritjes në detyrë në gjykatën e apelit të juridiksionit të përgjithshëm. Kështu rezulton se gjyqtarja ka mbi 7 vjet përvojë të përgjithshme profesionale, rezulton të ketë mbi 5 vjet përvojë profesionale specifike në fushën e së drejtës civile dhe në fushën e së drejtës penale, ku është konsideruar përvoja profesionale specifike gjatë kohës së stazhit, si dhe përvoja e saj si gjyqtare në të dyja fushat në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Ka rezultuar gjithashtu që kandidatja plotëson edhe kriterin tjetër të

mospasjes së masës disiplinore në fuqi dhe të mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale.

Në këto kushte, pasi relacioni dhe projekti përkatës kanë kaluar për diskutim në mbledhjen e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, është përgatitur projektvendimi përkatës, ku i propozohet Këshillit të Lartë Gjyqësor që të vendosë verifikimin e plotësimit nga kjo kandidate të kriterëve ligjore të përcaktuara nga ligji. Faleminderit, Kryetare!

**Naureda Llagami:** Faleminderit!

Keni ndonjë diskutim?

Nëse jo, kalojmë në procesin e votimit?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës dhe Vlorë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 129, datë 01.04.2021 dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 135, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, sipas propozimit të ardhur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

\* \* \*

(Pika 8 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 02.06.2021)*

**Pika 9 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për shqyrtimin e kërkesës për daljen në pension të parakohshëm të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore znj. Marçela Shehu).<sup>8</sup>

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:50 dhe mbaroi në orën 15:11.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
6. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)

<sup>8</sup> Sipas rendit të ditës kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e teta.

8. *Alban Toro* (anëtar)  
9. *Brikena Ukperaj* (anëtare)  
10. *Marçela Shehu* (anëtare)  
11. *Erjon Muharremaj* (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
4. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
5. *Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
6. *Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

9. Shqyrtimi i projektvendimit “Për shqyrtimin e kërkesës për daljen në pension të parakohshëm të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore znj. Marçela Shehu).

*Naureda Llagami:* Kalojmë tek projekt-akti tjetër që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për shqyrtimin e kërkesës për daljen në pension të parakohshëm të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës dhe do relatohet nga zonja Shehu.

*Marçela Shehu:* Faleminderit, Kryetare!

Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 23.03.2021, është depozituar një kërkesë nga gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, z. {...}, me nr. {...} prot., me objekt miratimin e pensionit të parakohshëm, referuar nenit 27 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Si shkak të paraqitjes

së kërkesës, magjistrati ka parashtruar moshën e tij, mbi 60 vjeç dhe kohën e gjatë të punës si gjyqtar.

Nga informacioni i marrë me datë 02.03.2021 në rrugë elektronike, nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit rezulton se: “Z. {...} ka marrë titullin Jurist, nga Universiteti i Tiranës në datën 25.03.1994. Fillimin në detyrë e ka me vendimin nr. {...}, datë 01.07.1994 të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ku është emëruar ndihmësgjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gramsh. Me vendimin nr. 4, datë 26.05.1995 është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Peqin. Në vijim, z. {...}, me vendimin nr. {...}, datë 30.05.1998 të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë transferohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, ku vazhdon të ushtrojë funksionin e gjyqtarit dhe aktualisht. Z. {...} me vendimin nr. 11, i është dhënë edhe një masë nga ish-Këshilli i lartë i Drejtësisë”.

Në rastin konkret, kërkesa e gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, z. {...} është bazuar në pikën 1, shkronja a, të nenit 27 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Këtu theksoj faktin që kërkesa është trajtuar referuar nenit 27 të ligjit nr. 96/2016 që ishte në fuqi në kohën e trajtimit të kësaj kërkesë në Komision, pasi siç e dini, neni 27 i këtij ligji ka pësuar disa ndryshime me ligjin nr. 50/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë””, ndryshime këto të cilat kanë hyrë në fuqi më datë 29.05.2021.

Gjithsesi unë po filloj me trajtimin që i është bërë kërkesës së magjistratit referuar nenit 27 i ligjit nr. 96/2016 i pa ndryshuar, i cili rezulton të ketë qenë në fuqi në kohën e trajtimit të kërkesës, për të vijuar më tej edhe në prezantimin e atyre ndryshimeve që ka sjellë ligji aktualisht.

Në nenin 27 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” lidhur me pensionin e parakohshëm parashikohet se:

1. Magjistrati gëzon të drejtën e pensionit të parakohshëm nëse:

a) ka mbushur të paktën moshën 60 vjeç;

b) ka ushtruar funksionin e magjistratit për të paktën 30 vjet, duke përfshirë edhe periudhën e komandimit;

c) nuk është në gjendje të ushtrojë funksionin e tij, për shkak të sëmundjes, të vërtetuar nga komisioni mjekësor i caktimit të aftësisë në punë. ...

Bazuar në pikën 3 të nenit 27 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ku parashikohet se: “Këshillat miratojnë pensionin e parakohshëm të magjistratit, pasi kanë marrë më parë mendimin e kryetarit të gjykatës”, u kërkua nga kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, dhënia e mendimit lidhur me kërkesën e gjyqtarit {...} për dalje në pension të parakohshëm.

Lidhur me këtë kërkesë, me shkresën nr. 585 datë 12.5.2021, zv/kryetarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan ndër të tjera parashittoi se: “Në cilësinë e zv/kryetares së gjykatës, ju bëj me dije se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan aktualisht përbëhet nga 9 gjyqtarë, nga të cilët 6 gjyqtarë në seksionin penal dhe 3 gjyqtarë në seksionin civil, bazuar kjo në ngarkesën e punës në secilin seksion. Gjyqtari {...} bën pjesë në seksionin penal dhe largimi i tij do bënte që ky seksion të mbetej me 5 gjyqtarë. Si rrjedhim, largimi i tij nga detyra mund të ndikojë në rritjen e ngarkesës së gjyqtarëve të tjerë, por nisur nga numri i lartë i gjyqtarëve në këtë seksion, bën që ngarkesa të jetë e përballueshme dhe largimi i tij në rast pranimi të kërkesës për dalje në pension të parakohshëm nuk ndikon në funksionalitetin e gjykatës.”

Bazuar në interpretim të ligjit që unë citova pak më sipër dhe rrethanave që u parashtruan në këtë relacion, rezulton që në këtë rast nuk plotësohen kërkesat që përcakton ligji, me qëllim që Këshilli, si organi ligjor përgjegjës, të jetë në kushtet e miratimit të kërkesës për pension të parakohshëm, të paraqitur nga magjistrati {...}, për shkak se, pavarësisht faktit të mbushjes së moshës 61 vjeç (me datë 25.03.2021), rezulton se gjyqtari është emëruar më datë 01.07.1994, duke mos plotësuar kështu kërkesën tjetër ligjore që parashikon neni 27 pika 1, germa “b”, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pra nuk plotëson kriterin e ushtrimit të profesionit të magjistratit për të paktën 30 vjet. Rezulton se gjyqtari {...} ka afërsisht 27 vjet që ushtron këtë detyrë. Gjithashtu rezulton që në këtë rast nuk plotësohet as kriteri tjetër ligjor që përcakton germa “c” e pikës 1 të nenit 27 të ligjit nr. 96/2016, ajo e paaftësisë së gjyqtarit për të ushtruar këtë funksion për shkak të sëmundjes, vërtetuar nga Komisioni mjekësor i caktimit të aftësisë në punë, kriter ky i cili duhet të vërtetohet



si i tillë në mënyrë kumulative bashkë me dy kriteret e tjera që përcakton ligji, moshë dhe vjetërsia në punë.

Sjell në vëmendjen tuaj se edhe nëse kërkesa e gjyqtarit do të trajtohej dhe do të vlerësohej referuar ndryshimeve që tashmë i janë bërë nenit 27 të ligjit nr. 96/2016, që rezulton tashmë që kanë hyrë në fuqi, rezulton sërish se kërkesa e gjyqtarit {...} nuk plotëson kriteret që përcakton ligji, pasi edhe neni 27 i ligjit nr. 96/2016 i ndryshuar, përcakton si kriteret kumulative ligjore, me qëllim përfitimin e pensionit të parakohshëm nga ana e magjistratit, moshën 60 vjeç dhe vjetërsinë në punë si magjistrat prej 30 vjetësh.

Më poshtë është cituar edhe përmbajtja e dispozitës, pra nenit 27 të ligjit nr. 96/2016, tashmë i ndryshuar.

Mbi sa më lart, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, lidhur me kërkesën e paraqitur nga gjyqtari {...}, i paraqet Këshillit të Lartë Gjyqësor këtë projektvendim, duke propozuar që kërkesa e këtij magjistrati të mos pranohet, duke qenë se nuk plotësohen kërkesat që kërkon ligji në këtë rast. Faleminderit, Kryetare!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, Marçela!

Atëherë, kemi ndonjë diskutim nga kolegët?

**Brunilda Kadi:** Kam unë Kryetare!

**Naureda Llagami:** Po, Bruna!

**Brunilda Kadi:** Atëherë, fillimisht dua të sqaroj që në lidhje me gjyqtarin {...} nga ana ime është votuar, si në të gjitha rastet, kundër dorëheqjes së tij nga dorëheqja, pasi kam atë arsytimin që kam, të cilin s'po e përsëris.

Por në kushtet kur Këshilli ka vendosur ndryshe, ky vendim është në fuqi, tani më duhet të vijoj të mbaj qëndrim në lidhje me këtë kërkesë.

Sot, për shkak të vendimit të Këshillit, zoti {...} është gjyqtar dhe ushtron detyrën dhe ka bërë kërkesë për pension të parakohshëm. Thjesht, shkurtimisht dua të them, ndryshe nga propozimi në relacion, unë interpretoj kushtet e nenit 27 që nuk janë

kumulative, siç sillet propozimi, por mendoj që mjafton të provohet njëra prej tyre dhe përfitohet ky pension.

Është një arsyetim tek Komisioni ku bëhet edhe historiku i legjislacionit, megjithëse unë mendoj që, e para, ligji nuk e thotë shprehimisht që janë kumulative dhe e dyta, logjikisht kushtet nuk mund të jenë kumulative.

Një person që mbush moshën 60 vjeç është më se e logjishme të kërkojë të dalë në pension të parakohshëm dhe nuk ka kuptim që ai të ketë edhe 30 vite të tjera përvojë. Është pothuajse ndoshta e pamundur që të plotësohen ndonjëherë këto kushte. Kështu që jam kundër propozimit dhe vlerësoj se kërkesa e magjistratit duhet të pranohet. Faleminderit!

*Naureda Llagami:* Faleminderit, zonja Kadi!

*Maksim Qoku:* Kam edhe unë diçka zonja Kryetare!

*Naureda Llagami:* Po, Maksim!

*Maksim Qoku:* Faleminderit!

Pa dashur që të përsëris logjikën e koleges, zonjës Kadi, edhe unë jam mbështetës i qëndrimit të saj, pasi gjykoj që për nga koncepti i ndërtimit të normës, këndvështrimit të teknikës legjislative, rastet që jepen në pikën 1 të nenit 27, përkundrazi nuk janë raste kumulative por janë alternative, çka do të thotë që mjafton të plotësohet njëri prej tyre.

Logjikën time, ndër të tjera, e mbështes tek fakti që, vetë natyra e kushteve që përmbahen në këto pika është e ndryshme, pasi po të gjykojmë në aspektin e dy pikave të para, këto janë fakte natyrale, që janë të konstataueshëm lidhur me momentin kur bëhet kërkesa, pra nga dita që ke lindur, deri kur bën kërkesën, ke mbushur moshën 60 vjeç apo nga dita që ju jeni emëruar në detyrë dhe deri në bërjen e kërkesës, keni 30 vite punë.

Ndërkohë, pavarësisht se pika “c” është shfuqizuar tashmë, nëse do ta merrnim në konsideratë, kjo fare mirë tregon që këto kushte s’mund të jenë kumulative për faktin që pika e tretë është në fakt një kusht objektiv, pra ka të bëjë me një ngjarje që nuk dihet nëse do të ndodhë, dhe nëse do të ndodhë, çdokush nga magjistratët mundet që të kërkojë

pension të parakohshëm në lidhje me situatën që iu shfaqet, pa mbushur moshën 60 vjeç apo edhe pa pasur 30 vjet. Prandaj gjykoj që ligjvënësi ka dashur të japë këto pika të ndara dhe këto mbeten alternative si pika në këtë nen.

Ajo çfarë dua të them tjetër është edhe fakti që ne jemi në ligjin “Për statusin e magjistratit” dhe natyrisht neni 27 futet tek Kreu V i këtij ligji “Të drejta të tjera të magjistratit”, i cili pasohet nga dy krerë që kanë të bëjnë me “Përfitimet në pagë” dhe “Përfitime të tjera të magjistratit”, çka do të thotë edhe në rastin e kësaj dispozite, i vendosur në këtë pjesë të ligjit, duke u trajtuar si një e drejtë e magjistratit që buron nga statusi, nuk do të ishte në asnjë rast synimi i ligjvënësit që të bënte kushte të rënduara të asaj natyre, që të kërkonte respektimin ose përmbushjen e tre kushteve kumulative, ku dy kanë natyrë mbase subjektive për sa përmbushen nga individi me kalimin e kohës dhe kushti i tretë ka natyrë objektive (sepse do të ishte e pamundur pastaj për t’u përmbushur). Megjithatë, duke qenë se pika “c” tashëm është shfuqizuar, mbetem prapë tek ideja që edhe kushtet e mbetura janë të natyrës alternative, pra mjafton të përmbushet çdonjëra prej tyre. Faleminderit!

*Naureda Llagami:* Faleminderit!

Ndonjë diskutim tjetër?

*Alban Toro:* Mundem?

*Naureda Llagami:* Po, zoti Toro!

*Alban Toro:* Unë e shikoj në një optikë, ashtu siç e shikon edhe Komisioni, pra të ndryshme nga kolegu parafolës. Neni 27 ka si qëllim që të përmirësojë sistemin e kujdesit social për magjistratët, në mënyrë që atyre t’u garantohen përfitime financiare në përputhje dhe me dinjitetin e detyrës së tyre, madje edhe në rastet kur ata nuk kanë plotësuar kushtet për pensionin e plotë. Ky ka qenë edhe qëllimi i parashikimit të këtij neni dhe risia që ky nen ka sjellë në krahasim me nenet e tjera.

Fatkeqësisht, ligjvënësi aty ka përfshirë disa kritere të cilat nëse do të kishte ndërmend t’i shikonte si alternative, patjetër do të përdorte shprehje gramatikore të cilat

do të përjashtonin njëra-tjetrën, ndërkohë që, nuk është bërë një gjë e tillë. Subjekt i asaj dispozite janë ato magistratë që kanë mbushur moshën 60 vjeç, kanë ushtruar funksionin e magistratit të paktën 30 vjet, si dhe ata që për shkak të sëmundjes nuk janë më në gjendje për të ushtruar funksionin.

Pra të gjitha këto kritere, ligjvënësi i ka parashikuar të ndodhin në mënyrë kumulative. Në fund të fundit, pensioni i parakohshëm mbron magistratët të cilët nuk mund të përfitojnë, pra nuk dëshirojnë të përfitojnë një pension pleqërie, jo sepse nuk duan, por për shkak se nuk kanë mbushur moshën e daljes në pension, megjithatë për shkak të sëmundjes nuk janë në gjendje të ushtrojnë funksionin e tyre. Kështu që, ligji këtu ka parashikuar një veçanti, që këta të përfitojnë të paktën një pension të parakohshëm, në përputhje edhe me garancitë që jep neni 138 i Kushtetutës.

Kështu që, ashtu siç Komisioni ka parashikuar, edhe unë jam pjesë e këtij opinionit, por do të marrim në konsideratë që ky fond do të paguhet në fund të ditës nga ligji “Për sigurimet shoqërore”. Një interpretim i gabuar gjithmonë do të ndeshë edhe me ngurrimin e këtij institucioni, për të bërë një pagesë të cilët atyre do t’u dukej jo në përputhje me ligjin. Faleminderit!

***Ilir Toska:*** Mund ta kem fjalën?

***Naureda Llagami:*** Po, zoti Toska!

***Ilir Toska:*** Marr shkas nga diskutimet e mëparshme të kolegëve.

Në vlerësimin tim, pika 1 e nenit 27, në fakt, në interpretim literal, bën fjalë për disa raste që janë raste kumulative, pra do duhet të ekzistojnë të gjitha rastet që kërkon ligji për t’u trajtuar magistrati me pension të parakohshëm. Nëse do të ishte ndryshe, atëherë do të kishte përdorur shenja pikësimi apo fjalë që do ta përjashtonin njëra-tjetrën. Rasti konkret, fjala “nëse” që përdoret në fillim të paragrafit, paralajmëron numërim. Pra rastet numërohen njëra pas tjetrës dhe tërësia e tyre bën të gjithë kushtin që kërkon dispozita. Edhe në interpretim doktrinar mund të them që kjo dispozitë parashikon një mbrojtje nëpërmjet sistemit të sigurimeve shoqërore për magistratin, ndryshe nga më herët, që do të thotë që edhe koncepti i mbrojtjes nga sigurimet shoqërore kërkon në çdo

rast, për çdokënd pora jo vetëm për gjyqtarët, por për çdo punonjës, krijon mbrojtje duke plotësuar dy kushte: njëri është kushti i kontributeve (pra që është edhe periudha e vjetërsisë) dhe e dyta është moshë. Në asnjë rast tjetër sistemi i sigurimeve shoqërore nuk pranon të trajtojë me pension të reduktuar apo të pjesshëm (siç ka qenë deri në vitin 2015) asnjë prej punonjësve në Republikën e Shqipërisë. Në këtë kontekst, nuk mundet të pranojmë që një magjistrat duhet të marrë përfitimet thjesht për moshën apo për kontributet e paguara; do duhet të ekzistojnë të dyja. Fakti që ligjvënësi shfuqizoi shkronjën “c” të pikës 1, të nenit 27, tregon atë rëndesë që kishte bërë për magjistratët, pra duke i vendosur edhe një kusht shtesë, ndryshe nga të gjithë punonjësit e tjerë, atë e ka shfuqizuar dhe ka përcaktuar si dispozitë më vete kur mund të përfitohet pensioni i parakohshëm, në rastet e sëmundjeve, dhe e ka lidhur me nenin 67 të ligjit për Statusin.

Nga sa më lart, në vlerësimin tim, ajo që ne kemi propozuar si Komision është korrekte dhe në përputhje me ligjin, ndryshe do duhet të deformohej kuptimi dhe qëllimi i ligjvënësit, -sipas meje. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toska!

Ndonjë diskutim tjetër nga kolegët?

**Maksim Qoku:** Vetëm diçka për të sqaruar, të lutem zonja Kryetare!

Nisur nga fakti që edhe diskutimi im, mbase edhe i koleges tjetër, korrekt është, në bazë të ligjit është. Unë do t’i bindem vullnetit të votës, mënyra se si e mendon i gjithë Këshilli. Por, sa për arsyetimet e tjera, pastaj këto janë doktrinare dhe unë i qëndroj asaj për faktin që nëse pjesa e listës së ligjit nuk përjashton asgjë dhe është nënrenditëse dhe e dyta, ligji për Statusin nuk është në referencë të ligjit “Për sigurimet shoqërore”. Kështu që, aspekti i qëndrimit tonë nuk është i varur fare nga kushtet që përcakton në lidhje me moshën dhe kontributet në një ligj tjetër. Faleminderit!

**Ilir Toska:** Mund ta kem prapë fjalën?

Në fakt, nuk mora përsipër të komentoja vlerësimet tuaja. Unë theksova që ky është vlerësimi im. Fakti që e referova apo solla në vëmendjen tuaj ligjin “Për sigurimet

shoqërore”, që është ligji bazë, thjesht e solla për logjikën e asaj që parashikon neni 27, pra është një e drejtë për mbrojtjen nga sigurimet shoqërore. Prandaj bëra krahasimin, për të sjellë në vëmendje që edhe ligji për Statusin i kërkon të dyja këto kushte. Faleminderit!

**Maksim Qoku:** Nejse, pa dashur të bëj debat, ai ligj mund të jetë, por s’është i vetmi. Kjo është logjika që duhet të fiksohet. Nuk është më i vetmi ai ligj. Sot dispozitat janë referuese.

**Ilir Toska:** Në çdo ligj që parashikon mbrojtje nga sigurimet shoqërore, qoftë për minatorët, qoftë për ushtarakët apo për çdo kategori tjetër, naftëtarët, patjetër ligji kërkon dy kushte për t’iu krijuar mbrojtje: kontributet dhe moshën.

**Maksim Qoku:** Nejse, secili ka mendimin e vet dhe nuk ka ndonjë debat për këtë.

**Naureda Llagami:** Kemi ndonjë diskutim tjetër?

**Brikena Ukperaj:** Po, zonja Kryetare!

**Naureda Llagami:** Po!

**Brikena Ukperaj:** Atëherë, lidhur nga diskutimet që patën edhe kolegët, për sa i përket teknikës legjislativë dhe ndërtimit të nenit 27, në dukje duket në vlerësimin tim sikur kushtet e vendosura në këtë dispozitë nuk janë kumulative por janë alternative, sepse nëse do të ishin kumulative, siç ka bërë ligjvënësi në dispozita të tjera, do ta kishte parashikuar nëse përmbushen njëkohësisht. Ka shumë dispozita ku përdoret kjo terminologji ligjore.

Nga ana tjetër, pensioni i parakohshëm, si institut, nuk është përcaktuar, as në ligjin për Statusin por as sa i përket ligjit “Për sigurimet shoqërore”, se çfarë është pensioni i parakohshëm. Është pension i reduktuar? Është pension i pjesshëm? Është ndonjë lloj pensioni tjetër? Pra nëse do t’i referohemi ligjit “Për sigurimet shoqërore”,

nuk e gjejmë si pjesë të skemës së pensioneve pensionin e parakohshëm, gjejmë vetëm pensionin e reduktuar.

Me ndryshimet që pësuar ligji, ligjvënësi ka dashur ta barazojë këtë lloj pensioni, me një pension të reduktuar.

Megjithatë, duke kërkuar legjislacione të ndryshme, lidhur me kuptimin e pensionit të parakohshëm, referuar ligjit për sa i përket përfitimeve të pensionit të ushtarakëve apo për ish-ushtarakët, rezulton që pensionin e parakohshëm e lidh gjithmonë me plotësimin e të dyja kushteve, pra e lidh edhe me moshën, edhe me periudhën e sigurimit. Pra pensioni i parakohshëm, si institut, unë vlerësoj që, kërkon detyrimisht plotësimin e të dyja kushteve, kërkon edhe moshën, që ligji ynë e ka përcaktuar 60 vjeç, kërkon edhe periudhën minimale të sigurimit, që në këtë rast ka të bëjë me 30 vjet ushtrimin e funksionit si magjistrat, pra jo 30 vjet eksperiencë pune, sepse gjyqtari mund të ketë edhe eksperiencë pune në fusha të tjera përveç asaj të ushtrimit të funksionit të gjyqtarit.

Nga ana tjetër, nëse do të pranoni që në teknikën legjislative, pra do të bënim një interpretim gramatikor të ligjit dhe të konkludoni që ato janë alternative, do të rezultonte që një gjyqtar që ka mbushur 60 vjeç por që ka hyrë në sistem 55 vjeç, do kishte vetëm 5 vite punë eksperiencë, dhe normalisht nuk mund të përfitojë një pension të parakohshëm kur nuk ka as minimumin e kontributit që duhet për një pension pleqërie që është 15 vjet.

Prandaj vlerësoj që të dyja kushtet duhet të jenë kumulative, pra duhet që të jetë edhe mosha, duhet të jetë edhe periudha e sigurimit. Në këtë rast ligji ka pranuar që të jetë mosha 60 vjeç dhe periudha e sigurimit 30 vite.

Nga ana tjetër, nëse ne sot do të vendosim pranimin e kërkesës për pension të parakohshëm, në fakt do të ishim në pamundësi zbatimi të vendimit se nuk kemi akoma rregullat e miratuara. Sipas nenit 27, pika 4, rregullat për mënyrën e llogaritjes së pensionit të parakohshëm dhe përfitimeve, në rastet kur pranohet kërkesa, duhet t'i miratojë Këshilli. Kjo e vë pak në dilemë mënyrën se si do të disponojmë sot për ata që mendojnë që duhet t'i pranohet kërkesa për pension të parakohshëm.

Për shkak edhe të këtij interpretimi dhe jo thjesht një interpretimi gramatikor apo teknikës legislative të ndërtimit të dispozitës, por për sa i përket interpretimit lidhur me institutin e pensionit të parakohshëm, unë jam dakord me propozimin e Komisionit të Karrierës për mospranimin e kërkesës. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zonja Ukperaj!

Kemi ndonjë diskutim tjetër?

Atëherë, kemi dy qëndrime. Kemi qëndrimin e parë të Komisionit dhe qëndrimin e dytë që nuk janë dakord me propozimin e ardhur. Kështu që unë po hedh në votim propozimin e Komisionit.

**Maksim Qoku:** Kundër.

**Brunilda Kadi:** Kundër.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Illir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Kundër.

**Naureda Llagami:** Dakord.

*(8 vota pro dhe 3 vota kundër.)*

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Mospranimin e kërkesës për dalje në pension të parakohshëm të gjyqtarit {...}.

2. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit z. {...} dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

3. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, brenda 15 ditëve nga dita e njoftimit.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.



\* \* \*

(Pika 9 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 02.06.2021)*

**Pika 10 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i dy projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska):

10.1 “Për fillimin e procedurave të përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 174, datë 28.05.2020 dhe nr. 392, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”;

10.2 “Për fillimin e procedurave të përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 394 dhe 395, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.<sup>9</sup>

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:50 dhe mbaroi në orën 15:11.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
- 3. Medi Bici*** (anëtar)

<sup>9</sup> Sipas rendit të ditës kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e nënta.

- |                             |                  |
|-----------------------------|------------------|
| <b>4. Fatmira Luli</b>      | <b>(anëtare)</b> |
| <b>5. Dritan Hallunaj</b>   | <b>(anëtar)</b>  |
| <b>6. Brunilda Kadi</b>     | <b>(anëtare)</b> |
| <b>7. Ilir Toska</b>        | <b>(anëtar)</b>  |
| <b>8. Alban Toro</b>        | <b>(anëtar)</b>  |
| <b>9. Brikena Ukperaj</b>   | <b>(anëtare)</b> |
| <b>10. Marçela Shehu</b>    | <b>(anëtare)</b> |
| <b>11. Erjon Muharremaj</b> | <b>(anëtar)</b>  |

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 4. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 5. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.**
- 6. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.**

#### **RENDI I DITËS:**

10. Shqyrtimi i dy projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska):

10.1 “Për fillimin e procedurave të përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 174, datë 28.05.2020 dhe nr. 392, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”;

10.2 “Për fillimin e procedurave të përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 394 dhe 395, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

**Naureda Llagami:** Kalojmë në projekt-aktin e radhës e cila ka të bëjë në fakt me dy projektvendime, të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

E para ka të bëjë me fillimin e procedurave të përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 174, datë 28.05.2020 dhe nr. 392, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe e dyta ka të bëjë me fillimin e procedurave të përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 394 dhe 395, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Për të dyja këto akte, relator do të jetë zoti Toska.

***Ilir Toska: Faleminderit!***

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ju ka propozuar dy projektvendime, i pari është “Për fillimin e procedurave të përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 174, datë 28.05.2020 dhe nr. 392, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor” dhe projektvendimi i dytë është “Për fillimin e procedurave të përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 394 dhe 395, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”. Për të dy këto projektvendime është përgatitur një relacion i cili është përcjellë më herët për të gjithë anëtarët.

Shkurtimisht mund t’ju them se Këshilli i Lartë Gjyqësor pas plotësimit të kuadrit ligjor nëpërmjet miratimit të akteve nënligjore të autorizuara nga ligji dhe me miratimin në muajin shkurt edhe të Vendimit nr. 70, datë 07.02.2020, “Për kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, në kohë të ndryshme, ka hapur procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve, ndër të tjera, edhe në Gjykatën e Apelit Durrës dhe në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Lidhur me procedurat e ngritjes në detyrë dhe verifikimi i kandidatëve - Për Gjykatën e Apelit Durrës.

Më datë 28.05.2020, Këshilli hapi procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve edhe në Gjykatën e Apelit Durrës, gjithsej për 2 (dy) pozicione të lira, nga të cilat 1 (një) pozicion në fushën e të drejtës civile dhe 1 (një) pozicion në fushën e të drejtës penale, respektivisht me Vendimet nr.173 dhe nr. 174.

Sa i përket procedurës së ngritjes në detyrë për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 173, datë 28.05.2020, pas

kualifikimit të dy kandidatëve që kanë kandiduar për këtë pozicion të lirë, Këshilli me Vendimin nr. 57, datë 16.02.2021, ka filluar procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve për këtë procedurë ngritjeje në detyrë, duke caktuar si relator z. Ilir Toska. Procedura e përzgjedhjes në këtë rast vijon, ndërsa për kandidatët nuk kanë përfunduar ende proceset e vlerësimit etik dhe profesional.

Ndërkohë, në procedurën e ngritjes në detyrë për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 174, datë 28.05.2020, brenda afatit të kandidimit, që ka qenë data 15.06.2020, kandiduan gjithsej tre kandidatë e konkretisht: znj. {...}, z. {...} dhe znj. {...}. Për këta kandidatë, pas përfundimit të afatit të kandidimit, me Vendimin nr. 238, datë 07.07.2020, Këshilli vendosi fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit, duke caktuar edhe relatorët përkatës për secilin kandidat.

Ndërsa procedura e verifikimit vijonte, kandidati z. {...}, me një kërkesë drejtuar Këshillit, u tërhoq nga kandidimi për këtë pozicion të lirë. Mbi këtë bazë, me Vendimin nr.286, datë 08.09.2020, Këshilli vendosi: Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës, për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi për pozicionin e shpallur me vendimin e Këshillit nr. 174 datë 28.05.2020.

Po ashtu, edhe kandidatja znj. {...} është tërhequr nga kandidimi për këtë pozicion të lirë dhe mbi kërkesën e të cilës Këshilli ka vendosur përfundimin e procedurës së ngritjes në Gjykatën e Apelit Durrës edhe për kandidaten {...} me Vendimin nr.539, datë 05.11.2020.

Kurse, për kandidaten e mbetur e vetme për pozicionin e lirë si më lart në fushën e të drejtës penale në Gjykatën e Apelit Durrës, pra për znj. {...}, në përfundim të procedurës së verifikimit, Këshilli, me Vendimin nr.170, datë 22.04.2021, ka vendosur kualifikimin e saj dhe vijimin e procedurës së ngritjes në detyrë në atë pozicion.

Nga ana tjetër, për këtë kandidate po vijon procedura e vlerësimit etik dhe profesional nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Ndërkohë në një raund tjetër, pikërisht më datë 07.10.2020, Këshilli hapi përsëri një procedurë ngritjeje në detyrë të gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit Durrës, për 1 (një) pozicion në fushën e të drejtës civile, me Vendimin nr.392.

Në këtë procedurë ngritjeje në detyrë, brenda afatit të kandidimit, që ishte data 23.10.2020, kandiduan gjithsej katër kandidatë e konkretisht: z. {...}; znj. {...}; znj. {...} dhe z. {...}. Për këta kandidatë, pas përfundimit të afatit të kandidimit, ka filluar procedura e verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit, duke me Vendimin nr. 541, datë 05.11.2020.

Aktualisht ka përfunduar procedura e verifikimit për një nga kandidatët që ka kandiduar për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr.392, datë 07.10.2020, pikërisht për znj. {...}, ndërsa Këshilli, me Vendimin nr. 204, datë 20.05.2021, ka vendosur kualifikimin e saj dhe vijimin e procedurës së ngritjes në detyrë në këtë pozicion.

Lidhur me Gjykatën e Apelit Tiranë - Në një nga raundet e radhës, pikërisht më datë 07.10.2020, Këshilli, ndër të tjera, ka hapur tre procedura ngritjeje në detyrë të gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit Tiranë, konkretisht për 2 (dy) pozicione të lira në fushën e të drejtës civile dhe 1 (një) pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale, respektivisht me Vendimet nr.394, nr. 395 dhe nr.396. Afati i kandidimit në të tria këto procedura ngritjeje në detyrë ishte deri më datë 23.10.2020.

Brenda afatit të kandidimit në procedurën e ngritjes në detyrë për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 394, datë 07.10.2020, kandiduan gjithsej tre kandidatë e konkretisht: znj. Irida Kacerja; znj. {...} dhe znj. {...}.

Po ashtu, brenda afatit të kandidimit në procedurën e ngritjes në detyrë për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 395, datë 07.10.2020, kandiduan gjithsej katër kandidatë e konkretisht: znj. {...}, znj. Lutfije Celami, znj. {...} dhe z. {...}.

Ndërsa në procedurën e ngritjes në detyrë për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 396, datë 07.10.2020, brenda afatit të kandidimit kandiduan gjithsej katër kandidatë e konkretisht: znj. {...}; znj. {...} znj. {...} dhe znj. {...}.

Për kandidatët si më lart, pas përfundimit të afatit të kandidimit, me Vendimin nr. 541, datë 05.11.2020, vendosi fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit, duke caktuar edhe relatorët përkatës për secilin kandidat.

Aktualisht ka përfunduar procedura e verifikimit për një nga kandidatët që ka kandiduar për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 394 dhe nr. 395, datë 07.10.2020, pikërisht për znj. {...}, për të cilën, si dhe më lart u parashtrua, Këshilli, me Vendimin nr. 204, datë 20.05.2021, ka vendosur kualifikimin e saj dhe vijimin e procedurës së ngritjes në detyrë në këto pozicione.

Për kandidatët që kanë kandiduar për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me Vendimin nr. 396, datë 07.10.2020, Këshilli ende nuk ka vendosur për kualifikimin e ndonjërit prej tyre.

Lidhur me procedurën e përzgjedhjes - Në Vendimin e Këshillit nr. 70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, Kreun V (“Rregulla të përgjithshme të procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë”), Seksioni A, titulluar “Fillimi i procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë dhe caktimi i relatorit”, pika 24, parashikohet se: “Këshilli, jo më vonë së 7 ditë nga vendimi i parë për kualifikimin e një kandidati, vendos fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë, si dhe cakton, nëpërmjet shortit, relatorin për atë procedurë. ...”. Ndërsa, në Kreun VI (“Fazat e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë”), Seksioni B, titulluar “Veprimet procedurale dhe verifikuese të relatorit”, pika 45, parashikon se: “Procedura e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë zhvillohet paralelisht: a) me procedurat e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit, të pasurisë dhe të figurës për kandidatët e tjerë që konkurrojnë për atë pozicion të lirë; ...”.

Nga ana tjetër, në këtë akt nënligjor, Kreun III (“Përkufizime”), pika 7, shkronja “j”, përcaktohet se: “Procedurë përzgjedhjeje për ngritjen në detyrë”, nënkupton procesin administrativ të renditjes dhe përzgjedhjes, sipas rastit, kandidatin ose kandidatët e renditur më lart”. Më tej, në shkronjën “d”, të kësaj pike, përcaktohet se: “Komision”, nënkupton Komisionin e Zhvillimit të Karrierës pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, që përbëhet nga tre anëtarë, anëtarët e përhershëm ose zëvendësues, duke ruajtur në çdo rast kompozimin e tij sipas pikës 10, neni 62, të Ligjit për Qeverisjen”. Ndërsa, në shkronjën “g”, të kësaj pike, përcaktohet se: “Relator”, nënkupton anëtarin e përhershëm ose

zëvendësues të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, që zgjidhet me short për të realizuar një procedurë përzgjedhjeje për ngritjen në detyrë”.

Ndaj sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur dy projektvendime të përmendura në hyrje të këtij relati.

Nëpërmjet projektvendimit të parë, Këshillit i propozohet të vendosë fillimin e procedurave të përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës, për dy pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr. 174, datë 28.05.2020 dhe nr. 392, datë 07.10.2020.

Ndërsa nëpërmjet projektvendimit të dytë, Këshillit i propozohet të vendosë fillimin e procedurave të përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për dy pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr. 394 dhe nr. 395, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Po ashtu, sipas këtyre projektvendimeve, Këshilli do të duhet të caktojë relatorin për çdo procedurë përzgjedhjeje për ngritjen në detyrë në gjykatat respektive të apelit. Lidhur me këtë, sipas projektvendimeve, Komisioni ka vlerësuar që në rrethanat kur janë dy gjykata për të cilat do të vijojë procedura e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë të kandidatëve, ku në secilin prej tyre për dy pozicione të lira, me qëllim administrimin sa më mirë dhe me efikasitet të këtij procesi, si dhe duke konsideruar një shpërndarje të barabartë të ngarkesës mes relatorëve, është propozuar që caktimi i tyre të bëhet në këtë mënyrë: 1 relator për 2 (dy) procedurat e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës dhe 1 relator për 2 (dy) procedurat e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Sa i përket relatorëve për secilën procedurë përzgjedhjeje për ngritjen në detyrë, bazuar në Vendimin e Këshillit nr. 70, datë 07.02.2020, ata duhet të zgjidhen me short ndërmjet 3 anëtarëve të përhershëm të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës.

Lidhur me shortin propozohet të ndiqen të njëjtat rregulla si dhe më parë, ku në një enë të hidhen shiritat e letrës me emrat e anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, ndërsa në një enë tjetër të hidhen shiritat e letrës me emrat e dy gjykatave, Gjykatës së Apelit Durrës dhe Gjykatës së Apelit Tiranë. Më pas, shorti të vijojë me



tërheqjen e një prej shiritave të letrës në enën me emrat e anëtarëve të Komisionit, i cili ngarkohet si relator për dy procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve për ngritjen në detyrë të gjykatës së apelit, shiriti me emrin e të cilës do të tërhiqen në këtë rast. Më tej, shorti të vijojë në të njëjtën mënyrë edhe për relatorin e dytë, duke u tërhequr një nga shiritat e mbetur me emrin e anëtarëve, i cili ngarkohet si relator për dy procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve për ngritjen në detyrë të gjykatës së apelit, shiriti me emrin e të cilës ka mbetur në enën përkatëse.

Projektvendimet e propozuara janë strukturuar në 2 pika.

Pikat 1 të projektvendimeve bëjnë fjalë për fillimin e procedurave të përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në gjykatat respektive të apelit, duke specifikuar dhe pozicionet e lira përkatëse.

Pikat 2 të projektvendimeve bëjnë fjalë për caktimin e relatorit, pas zhvillimit të shortit, për secilën procedurë përzgjedhjeje për ngritjes në detyrë, referuar pikave 1 të tyre.

Së fundi, në projektvendime parashikohet dhe momenti i hyrjes së tyre në fuqi, konkretisht menjëherë me botimin e vendimeve në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

***Naureda Llagami:*** Faleminderit, zoti Toska!

Vijojmë me shortin për hedhjen e relatorëve.

Procedura e shortit:

Fillimisht futen në vazon e qelqit shiritat e letrës me emrat e relatorëve: z. Ilir Toska, znj. Marçela Shehu dhe z. Alban Toro.

Futen më pas në enën tjetër të qelqit shiritat e letrës me emrat e dy gjykatave: Gjykata e Apelit Tiranë dhe Gjykata e Apelit Durrës.

Nga përzgjedhja në short rezulton si më poshtë: z. Alban Toro, relator për procedurat e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, ndërsa z. Ilir Toska, relator për procedurat e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës.

**Naureda Llagami:** Faleminderit!

Atëherë, kalojmë në votimin e dy projekt-akteve.

Projekt-akti i parë lidhur me Gjykatën e Apelit Durrës, zoti Toska dhe për Gjykatën e Apelit Tiranë, z. Toro.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Fillimin e procedurave të përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale dhe të së drejtës civile, të shpallura me Vendimet nr.174, datë 28.05.2020 dhe nr. 392, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Caktimin e z. Ilir Toska si relator për këto procedura përzgjedhjeje për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë në procedurat e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë është zoti Toro. Jemi dakord?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

*Ilir Toska:* Dakord.

*Alban Toro:* Dakord.

*Fatmira Luli:* Dakord.

*Marçela Shehu:* Dakord.

*Erjon Muharremaj:* Pro.

*Brikena Ukperaj:* Pro.

*Medi Bici:* Pro.

*Naureda Llagami:* Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Fillimin e procedurave të përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet nr.394 dhe nr. 395, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Caktimin e z. Alban Toro si relator për këto procedura përzgjedhjeje për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 10 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 02.06.2021)*

**Pika 11 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).<sup>10</sup>

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:50 dhe mbaroi në orën 15:11.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
6. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)

---

<sup>10</sup> Sipas rendit të ditës kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e dhjeta.

7. *Ilir Toska* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
10. *Marçela Shehu* (anëtare)
11. *Erjon Muharremaj* (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
4. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
5. *Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
6. *Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

11. Shqyrtimi i projektvendimit “Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

*Naureda Llagami:* Kalojmë në projekt-aktin e radhës i cili ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës”, përgatitur nga zoti Toro.

*Alban Toro:* Faleminderit!

Për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës, si gjykatë në nevojë, konkretisht me vendimin nr. 47, datë 13.06.2018 është vendosur nga ana e Këshillit që “Gjyqtarja {...}, aktualisht gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet transferohet

përkohësisht për një vit nga hyrja në fuqi e këtij vendimi në Gjykatën e Administrative të Shkallës së parë Durrës”.

Me Vendim nr. 98, datë 21.06.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor znj. {...} i është zgatur afati i transferimit të përkohshëm për një periudhë deri në 1 (një) vit.

Me Vendim nr.203, datë 11.06.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor znj. {...} i është përsëritur transferimi i përkohshëm pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës për një periudhë deri në 1 (një) vit.

Me Dekretin nr. {...}, datë 16.11.2012, organika e kësaj gjykate paraqitet me 4 gjyqtarë, ku aktualisht në mënyrë të përhershme janë të emëruar dy gjyqtarë.

Me Vendimin nr. 222, datë 12.12.2019 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është vendosur ndër të tjera “Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. {...}, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.”

Në vijim kam paraqitur ngarkesat respektive të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës. Ndërkohë nga të dhënat të cilat ka vlerësuar Komisioni, rezulton se nevojat e kësaj gjykate nuk mund të plotësohen nëpërmjet skemës së delegimit, pasi të nëntë gjyqtarët e komanduar janë atashuar në gjykata të cilat janë në nevojë imediate për shkak të cenimit të funksionalitetit të tyre dhe si e tillë ata nuk mund të integrohen edhe në këtë gjykatë për të plotësuar nevojat e saj.

Gjithashtu, këto nevoja nuk mund të plotësohen as nëpërmjet përcaktimeve të Vendimit nr.30, datë 14.02.2019 i cili normon caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme.

Kështu që, i vetmi akt normativ i cili orienton dhe rregullon praktikën në fjalë është ai i vendimit nr. 23, 07.02.2019 i cili rregullon kriteret dhe procedurat e transferimit të përkohshëm të gjyqtarëve, bazuar kjo në pozicionet e lira të përkohshme për transferim të Gjykatës Administrative Durrës si dhe në faktin që citova më lart, se nuk ka gjyqtarë të disponueshëm në skemën e delegimit.

Duke u bazuar në këtë akt normativ, pra vendimin nr.23, datë 07.02.2019 me ndryshimet përkatëse, është parashikuar që Këshilli shpall pozicionin e lirë të

përkohshëm duke ftuar fillimisht për të dhënë pëlqimin gjyqtari që është transferuar në atë gjykatë nëse transferimi i tij nuk cenon funksionalitetin e gjykatës ku ai është caktuar në mënyrë të përhershme. Në një rast të tillë ky gjyqtar mund të transferohet përsëri përkohësisht në gjykatën në nevojë në rast se jep pëlqimin. Pikërisht ky është edhe drafti që ju është propozuar, në dispozitivin e të cilit do të gjeni:

Të shpallë një pozicion të lirë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës për transferim të përkohshëm deri në një vit.

Kjo shpallje i drejtohet gjyqtarës së transferuar, aktualisht në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës, znj. {...}, e cila të ftohet për të dhënë pëlqimin për përsëritjen e transferimit të përkohshëm.

Afati për dhënien e pëlqimit të jetë brenda dy ditëve nga njoftimi i këtij vendimi.

Ngarkohet Komisioni i Zhvillimit të Karrierës për kryerjen e procedurave të mëtejshme të transferimit të përkohshëm.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

*Naureda Llagami:* Kemi ndonjë diskutim?

Nëse jo, kalojmë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit?

*Maksim Qoku:* Dakord.

*Brunilda Kadi:* Dakord.

*Dritan Hallunaj:* Pro.

*Ilir Toska:* Dakord.

*Alban Toro:* Dakord.

*Fatmira Luli:* Dakord.

*Marçela Shehu:* Dakord.

*Erjon Muharremaj:* Pro.

*Brikena Ukperaj:* Pro.

*Medi Bici:* Pro.

*Naureda Llagami:* Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Të shpallë një pozicion të lirë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës për transferim të përkohshëm deri në një vit.

2. Kjo shpallje i drejtohet gjyqtarës së transferuar, aktualisht në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës, znj. {...}, e cila të ftohet për të dhënë pëlqimin për përsëritjen e transferimit të përkohshëm.

3. Afati për dhënien e pëlqimit të jetë brenda dy ditëve nga njoftimi i këtij vendimi.

4. Ngarkohet Komisioni i Zhvillimit të Karrierës për ndjekjen e hapave të mëtejshëm të procedurës së transferimit të përkohshëm.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 11 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 02.06.2021)*

**Pika 12 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për pozicionet e lira në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).<sup>11</sup>

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:50 dhe mbaroi në orën 15:11.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku** (zëvendëskryetar)
- 3. Medi Bici** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli** (anëtare)
- 5. Dritan Hallunaj** (anëtar)
- 6. Brunilda Kadi** (anëtare)
- 7. Ilir Toska** (anëtar)

---

<sup>11</sup> Sipas rendit të ditës kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 11-ta.

8. *Alban Toro* (anëtar)  
9. *Brikena Ukperaj* (anëtare)  
10. *Marçela Shehu* (anëtare)  
11. *Erjon Muharremaj* (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
4. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
5. *Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
6. *Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

12. Shqyrtimi i projektvendimit “Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për pozicionet e lira në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

*Naureda Llagami:* Kalojmë në projekt-aktin e radhës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për pozicionet e lira në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës dhe do relatohet nga zoti Toro.

*Alban Toro:* Faleminderit!

E njëjta situatë është edhe për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë e cila është konsideruar dhe identifikuar si gjykatë në nevojë për shkak të pozicioneve të lira dhe të përkohshme dhe ngarkesës relativisht të madhe që ka kjo gjykatë.

Më konkretisht, me vendimin nr. 47, datë 13.06.2018 nga ky Këshill është vendosur që “Gjyqtari {...}, aktualisht gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë

transferohet përkohësisht për një vit nga hyrja në fuqi e këtij vendimi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë...” dhe “Gjyqtare {...}, aktualisht gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat transferohet përkohësisht për një vit nga hyrja në fuqi e këtij vendimi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësorë Kavajë...”.

Me vendime të veçanta, të dy gjyqtarëve i është zgjatur për 1 vit transferimi i përkohshëm.

Me Dekretin nr.{...}, datë 16.11.2012, organika e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë ka 4 gjyqtarë, ku aktualisht janë emëruar në mënyrë të përhershme në funksionin e gjyqtarit z. {...} dhe znj. {...} dhe {...}.

Me Vendimin nr. {...}, datë 04.06.2020 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është vendosur ndër të tjera “Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. {...}, me detyrë gjyqtar/drejtues i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë...”.

Në vijim është paraqitur ngarkesa respektive e gjykatës si dhe fakti që kjo gjykatë në nevojë nuk mund të plotësojë kërkesat nëpërmjet skemës së delegimit pasi të nëntë gjyqtarët e komanduar dhe që përfshihen në skemën e delegimit, aktualisht janë caktuar në gjykatat që kanë nevojë imediate nga pikëpamja e funksionalitetit dhe si e tillë është e pamundur që ata të adresojnë dhe të përmbushin kërkesat e kësaj gjykate. Gjithashtu, nuk mund të plotësohet as nëpërmjet caktimit të vendimit nr. 30, datë 14.02.2019, Rregullore e cila trajton caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera të ndryshme nga ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme. Kështu që, i vetmi akt normativ që rregullon këtë procedurë është vendimi nr. 23, datë 07.02.2019 i cili normon transferimin e përkohshëm të gjyqtarëve.

Ky akt bazohet, në faktin e përcaktimit të gjykatës në nevojë, fakti që nuk ka gjyqtarë të disponueshëm në skemën e delegimit si dhe vlerëson që në rastet kur nuk mund të aplikohet rregullorja për caktimin e gjyqtarëve në çështje gjyqësore të veçanta, siç është edhe rasti aktual.

Kështu që në këto kushte, mbas vlerësimit të një situatë të tillë nga Komisioni ju propozohet: 1. Të shpallë dy pozicione të lira pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë për transferim të përkohshëm deri në një vit.

2. Kjo shpallje i drejtohet gjyqtarëve të transferuar, aktualisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë znj. {...} dhe z. {...}, të cilët të ftohen për të dhënë pëlqimin për përsëritjen e transferimit të përkohshëm.

3. Afati për dhënien e pëlqimit të jetë brenda dy ditëve nga njoftimi i këtij vendimi.

4. Ngarkohet Komisioni i Zhvillimit të Karrierës për ndjekjen e hapave të mëtejshëm të procedurës së transferimit të përkohshëm.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

***Naureda Llagami:*** Faleminderit!

Atëherë, ftoj kolegët nëse kanë ndonjë diskutim mbi projekt-aktin.

Nëse jo, kalojmë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit të sjellë nga Komisioni?

***Maksim Qoku:*** Dakord.

***Brunilda Kadi:*** Dakord.

***Dritan Hallunaj:*** Pro.

***Illir Toska:*** Dakord.

***Alban Toro:*** Dakord.

***Fatmira Luli:*** Dakord.

***Marçela Shehu:*** Dakord.

***Erjon Muharremaj:*** Pro.

***Brikena Ukperaj:*** Pro.

***Medi Bici:*** Pro.

***Naureda Llagami:*** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Të shpallë dy pozicione të lira pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë për transferim të përkohshëm deri në një vit.

2. Kjo shpallje i drejtohet gjyqtarëve të transferuar, aktualisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë znj. {...} dhe z. {...}, të cilët të ftohen për të dhënë pëlqimin për përsëritjen e transferimit të përkohshëm.

3. Afati për dhënien e pëlqimit të jetë brenda dy ditëve nga njoftimi i këtij vendimi.

4. Ngarkohet Komisioni i Zhvillimit të Karrierës për ndjekjen e hapave të mëtejshëm të procedurës së transferimit të përkohshëm.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 12 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 02.06.2021)*

**Pika 13 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i dy projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska):

13.1 “Për komandimin në Skemën e Delegimit të gjyqtarit z. {...}”;

13.2 “Për caktimin e gjyqtarit të Skemës së Delegimit z. {...} në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”.<sup>12</sup>

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:50 dhe mbaroi në orën 15:11.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Naureda Llagami</b> | <b>(kryetare)</b>        |
| <b>2. Maksim Qoku</b>     | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>3. Medi Bici</b>       | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>4. Fatmira Luli</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Dritan Hallunaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |

<sup>12</sup> Sipas rendit të ditës kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 12-ta.

- |                             |                  |
|-----------------------------|------------------|
| <b>6. Brunilda Kadi</b>     | <b>(anëtare)</b> |
| <b>7. Ilir Toska</b>        | <b>(anëtar)</b>  |
| <b>8. Alban Toro</b>        | <b>(anëtar)</b>  |
| <b>9. Brikena Ukperaj</b>   | <b>(anëtare)</b> |
| <b>10. Marçela Shehu</b>    | <b>(anëtare)</b> |
| <b>11. Erjon Muharremaj</b> | <b>(anëtar)</b>  |

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 4. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 5. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.**
- 6. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.**

#### **RENDI I DITËS:**

13. Shqyrtimi i dy projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska):

13.1 “Për komandimin në Skemën e Delegimit të gjyqtarit z. {...}”;

13.2 “Për caktimin e gjyqtarit të Skemës së Delegimit z. {...} në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”.

**Naureda Llagami:** Kalojmë në projekt-aktet e radhës të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Projektvendimi i parë ka të bëjë “Për komandimin në Skemën e Delegimit të gjyqtarit z. {...}” dhe projekt-akti i dytë ka të bëjë me caktimin e gjyqtarit të Skemës së Delegimit z. {...} në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”. Për më shumë detaje fjalën ia jap zotit Toska.

**Ilir Toska:** Faleminderit!

Sa i përket gjyqtarit {...}, siç parashtroi edhe Kryetarja, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur dy projektvendime.

Po filloj me projektvendimin e parë, pasi i dyti është i kushtëzuar nga ky projektvendim.

Projektvendimi i parë ka të bëjë me komandimin në Skemën e Delegimit të gjyqtarit z. {...}. Për këtë projektvendim ju është përcjellë edhe relacioni shpjegues. Shkurtimisht mund t'ju parashtroj se më datë 27.05.2021, gjyqtari {...} ka paraqitur një kërkesë për shprehje interesi para Këshillit të Lartë Gjyqësor, protokolluar me aktin nr. {...}, datë 27.05.2021, me të cilën ka dhënë pëlqimin për të shërbyer në skemën e delegimit, specifikisht edhe në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për të cilën ka kandiduar për ngritjen në detyrë (për pozicionin e shpallur me Vendimin e Këshillit nr.223, datë 02.07.2020), procedurë kjo që është në proces e sipër.

Nga analiza e të dhënave në dosjen personale, referuar edhe vendimit të Këshillit marrë në kuadër të procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Vendimit nr.295, datë 10.09.2020, sipas informacionit të marrë nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, konstatohet se z. {...} ka filluar detyrën si gjyqtar me Dekretin e Presidentit të Republikës nr. {...}, datë 10.10.2012, kur është emëruar për të kryer stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në vijim, me Dekretin e Presidentit të Republikës nr.8470, datë 23.01.2014, ai është emëruar përfundimisht gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Më pas, me Vendimin nr. {...}, datë 18.11.2016, të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, z.{...} është transferuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku vijon të ushtrijë funksionin e gjyqtarit. Po ashtu, referuar informacionit të marrë, rezulton se z. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Neni 45 i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, përcakton rregullimin ligjor lidhur me organizimin dhe funksionimin e skemës së delegimit, kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen nga magjistratët për t’u pranuar në këtë skemë si dhe detyrimin e Këshillit për të miratuar



rregulla të detajuara për kriteret dhe procedurën për përzgjedhjen e magjistratëve si dhe kohën e shërbimit për skemën e delegimit, duke parashikuar ndër të tjera se: “1. Magjistratët në të gjitha shkallët, me të paktën një vit përvojë në funksion, mund të kandidojnë për t’u komanduar në një pozicion, në skemën e delegimit, e cila krijohet në Këshill. 2. Magjistrati shërben në skemën e delegimit jo më shumë se 5 vjet. 3. Magjistrati që kandidon për pozicione në skemën e delegimit, nënshkruan një deklaratë për dhënien e pëlqimit për t’u caktuar në çdo gjykatë ose prokurori.”

Në zbatim të nenit 45 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 22 datë 07.02.2019, ka miratuar Rregulloren për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit. Konkretisht neni 4 i kësaj rregulloreje parashikon kriteret e kandidimit në skemën e delegimit:

“Në skemën e delegimit kandidon çdo gjyqtar që plotëson këto kritere :

- a. Të ketë dhënë pëlqimin për t’u komanduar në skemën e delegimit;
- b. Të ketë jo më pak se 1 vit përvojë në funksion;
- c. Të mos jetë nën efektet e një mase disiplinore, zbatimi i së cilës mund të shmanget për shkak të përfshirjes në skemën e delegimit;
- d. Të mos ushtrojë funksionin e Kryetarit apo Zëvendëskryetarit;
- e. Të mos jetë i caktuar në mënyrë të përhershme në një gjykatë ku komandimi cenon funksionalitetin e saj;
- f. Të mos jetë duke ushtruar funksionin e tij si gjyqtar në një gjykatë tjetër për shkak të transferimit të përkohshëm me ose pa pëlqim”.

Bazuar në rrethanat e faktit të parashtruara më sipër, në lidhje me parashikimet ligjore të nenit 45 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në lidhje me parashikimet e Vendimit nr. 22, datë 07.02.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Komisioni vlerëson se në rastin konkret, jemi në kushtet e pranimit të përfshirjes së gjyqtarit {...} në skemën e delegimit, pra të komandimit të tij në këtë skemë pasi: gjyqtari ka dhënë pëlqimin për t’u komanduar në skemën e delegimit; ka më shumë se 1 vit përvojë në funksion; nuk ndodhet nën efektet e

një mase disiplinore, zbatimi i së cilës mund të shmanget për shkak të përfshirjes në skemën e delegimit; nuk ushtron funksionin e Kryetarit apo Zëvendëskryetarit; është i caktuar në mënyrë të përhershme në një gjykatë ku komandimi, në raport me situatën e sistemit gjyqësor në përgjithësi, nuk cenon rëndë funksionalitetin e saj në kushtet kur, aktualisht, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë ushtrojnë funksionin 55 gjyqtarë, ndërsa organika e saj është 76 të tillë, ndërkohë që 11 pozicione janë përkohësisht të lira dhe 10 të tjera janë të përhershme; nuk rezulton të jetë duke ushtruar funksionin e tij si gjyqtar në një gjykatë tjetër për shkak të transferimit të përkohshëm me ose pa pëlqim.

Sa më sipër, konkludohet se gjyqtari {...} plotëson kriteret për t'u komanduar në skemën e delegimit.

Në këto kushte, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor:

1. Pranimin e kërkesës së gjyqtarit z. {...}.
2. Komandimin e gjyqtarit z. {...} në skemën e delegimit të ngritur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, me afat deri në një vit, që mund të ndërpritet ose zgjatet në varësi të rrethanave.
3. Përrjashtimin e gjyqtarit z. {...} nga procedurat e shortit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
4. Gjyqtari i skemës së delegimit, z. {...}, ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet që ka në shqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për të cilat ka përfunduar apo është në përfundim të hetimit gjyqësor.
5. Efektet juridike të vendimit fillojnë nga data e njoftimit.
6. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit z. {...} sipas kërkesave të shkronjës "c", pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, kemi ndonjë diskutim nga kolegët?

Kalojmë në votimin e projekt-aktit të parë?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Illir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Pranimin e kërkesës së gjyqtarit z. {...}.

2. Komandimin e gjyqtarit z. {...} në skemën e delegimit të ngritur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, me afat deri në një vit, që mund të ndërpritet ose zgjatet në varësi të rrethanave.

3. Përfundimin e gjyqtarit z. {...} nga procedurat e shortit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

4. Gjyqtari i skemës së delegimit, z. {...}, ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet që ka në shqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për të cilat ka përfunduar apo është në përfundim të hetimit gjyqësor.

5. Efektet juridike të vendimit fillojnë nga data e njoftimit.

6. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit z. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë në projekt-aktin tjetër.

***Ilir Toska:*** Faleminderit!

Projekt-akti i dytë për zotën {...} është sa i përket caktimit të tij si gjyqtar i Skemës së Delegimit në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Edhe për këtë projektvendim ju është përcjellë relacioni përkatës. Shkurtimeisht mund t'ju parashtroj se në supozimin e miratimit të projektvendimit që e kaluam pak më herët, Komisioni i propozon Këshillit që gjyqtari skemës së delegimit z. {...} të caktohet në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Lidhur me këtë të fundit, si shkak për propozimin e këtij projektvendimi është situata në të cilën gjendet Gjykata e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, e cila aktualisht është me një numër të kufizuar gjyqtarësh ku në detyrë janë vetëm gjashtë gjyqtarë, ndërsa organika e saj është 16 gjyqtarë, ndërkohë që dy gjyqtarë në detyrë pranë saj janë në procedura ngritjeje në detyrë, çka do të thotë se një numër i tillë i gjyqtarëve të kësaj gjykate është i pamjaftueshëm duke mbajtur në konsideratë numrin e domosdoshëm të gjyqtarëve për formimin e trupave gjykues (në çdo rast do të kërkoheshin 3 ose 5), por edhe ngarkesën e çështjeve në këtë gjykatë, ku referuar informacionit të dërguar nga kjo gjykatë me shkresën nr.{...} prot., datë 21.05.2021, rezulton se numri mesatar i çështjeve të themelit për çdo gjyqtar është 8-9, kurse i çështjeve të tjera 20-21, numër ky i lartë krahasuar me standardin sasior të punës për gjyqtarët e kësaj gjykate referuar vendimit nr. {...}, datë 14.04.2010, të ish-KLD-së, që është pjesë e kuadrit nënligjor në fuqi për vlerësimin e gjyqtarëve sipas Vendimit nr.263, datë 21.11.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Po ashtu, mbahet në konsideratë se kjo gjykatë në vijimësi ka paraqitur nevojë, për një numër të lartë çështjesh, për caktim gjyqtarësh nga gjykatat e tjera sipas Vendimit të Këshillit nr. 30/2019.

Në një situatë të tillë, Gjykata e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar është në nevojë për pasjen në vijimësi në detyrë të një numri të

mjaftueshëm gjyqtarësh, çka do të mundësonte gjykimin normal të çështjeve të regjistruara përpara saj.

Meqenëse gjyqtari {...}, në supozimin tashmë të miratuar të projektvendimit për komandimin në Skemën e Delegimit, është tashmë gjyqtar i skemës së delegimit, nisur nga nevojat e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka propozuar caktimin e tij në këtë gjykatë, për të gjithë periudhën njëvjeçare të komandimit në këtë skemë.

Lidhur me këtë vlen të theksohet se gjyqtari z. {...} ka përvojë profesionale mbi 8 vjet, pra ka përvojën minimale profesionale që kërkon ligji, neni 47, pika 2, shkronja “a”, i Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, rrethanë kjo që i jep të drejtë Këshillit ta caktojë atë në këtë gjykatë për periudhën e komandimit në skemën e delegimit, sikurse përcaktohet në shkronjën “a”, pika 4, të nenit 45, të këtij ligji, sipas të cilës: “4. Këshilli cakton magjistratin në skemën e delegimit në bazë të nevojave të një gjykate ...: a) në çdo pozicion të njëjtit nivel ose të një niveli tjetër, për të cilin magjistrati përmbush kërkesat; ...”. Po ashtu, gjyqtari {...} plotëson edhe kushtet shtesë të sigurisë për t’u caktuar pranë gjykatave të posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar siç kërkon shkronja “b”, e kësaj dispozite, sipas të cilës Këshilli cakton magjistratin e skemës së delegimit në bazë të nevojave “b) në një pozicion në gjykatën e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar ..., nëse magjistrati përmbush kriteret, sipas nenit 47, të këtij ligji, si dhe jep pëlqimin sipas kërkesës së pikës 3, të nenit 47, të këtij ligji”. Kështu, z. {...} dhe familjarët e afërt të tij kanë plotësuar dhe dorëzuar rregullisht formularët e vetëdeklarimit për dhënien e pëlqimit për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, në kuadër të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (për pozicionin e shpallur me Vendimin e

Këshillit nr.223, datë 02.07.2020), referuar për këtë në Vendimin e Këshillit nr.295, datë 10.09.2020.

Projektvendimi i propozuar është i strukturuar në 5 pika.

Në pikën 1 të projektvendimit përcaktohet se gjyqtari në skemës e delegimit z. {...} caktohet për të gjykuar pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për periudhën deri më datë \_\_.\_\_.2022 (data nuk është shënuar në projektvendim sepse nuk dihej koha e shqyrtimit të projektvendimit), pikërisht deri në datën kur përfundon komandimi i tij në skemën e delegimit, pra në varësi të vendimit të mëparshëm të Këshillit. Sot është data 2 qershor dhe i bie që propozimi konkret të jetë për periudhën deri më datë 2 qershor 2022.

Në pikën 2 të projektvendimit përcaktohet se gjyqtari i skemës së delegimit z. {...} përjashtohet nga procedurat e shortit për caktimin e gjyqtarit relator në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për periudhën deri më datë \_\_.\_\_.2021 (është lënë e papërcaktuar), me përjashtim të çështjeve në të cilat gjyqtarët e kësaj gjykate do të kenë pengesë ligjore për gjykimin e tyre. Në këtë rast mbetet që Këshilli të përcaktojë periudhën e përjashtimit të z. {...} nga procedurat e shortit për caktimin e gjyqtarit relator në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, periudhë kjo që duhet të jetë në kufijtë e 3-4 javëve, ndërsa ky përjashtim propozohet për të evituar ngarkesën e tij dhe për të mundësuar përfundimin së gjykuari të çështjeve në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, sikurse është parashikuar në pikën 4, të projektvendimit të sapo miratuar nga ana e Këshillit. Po ashtu, sipas propozimit, është parashikuar një përjashtim nga ky rregull, pikërisht për çështjet në të cilat gjyqtarët e kësaj gjykate kanë pengesë ligjore për gjykimin e tyre, për të evituar në këtë mënyrë, gjatë kësaj periudhe të shkurtër të përkohshme, caktimin e z. {...}, si gjyqtar i skemës së delegimit, për plotësimin e trupit gjykues, si relator, për çështjet që do të rezultojnë të nevojshme. Nga ana tjetër, si anëtar i trupit gjykues, z. {...} përfshihet menjëherë me fillimin e efekteve të këtij vendimi.

Lidhur me periudhën deri kur do duhet të përjashtohet nga shorti për caktimin si relator në Gjykatën e Posaçme për Korrupsionin, është përcaktuar që të jenë në kufirin e

3-4 javëve, nisur nga fakti që Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe pikërisht seksioni penal ku ushtron funksionin zoti {...} ka një ngarkesë të lartë, propozoj që ky përjashtim të jetë 4 javë, pra deri në datën 1 korrik 2021. Kjo është sa i përket pikës 2.

Pika 3 e projektvendimit bën fjalë për fillimin e efekteve juridike të vendimit, pikërisht nga data e njoftimit.

Ndërkohë në pikën 4 të projektvendimit përcaktohet se efektet financiare sipas këtij vendimi përballohen nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Përcaktimi i këtij rregullimi merr në konsideratë faktin se kjo gjykatë ka buxhetin për të përballuar efektet financiare të vendimit, ndërsa ka pozicione të lira të përhershme.

Ndërsa në pikën 5 të projektvendimit përcaktohet se një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit në skemës e delegimit z. {...}, sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Së fundi në projektvendim përcaktohet publikimi i vendimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

***Naureda Llagami:*** Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, kemi ndonjë diskutim nga kolegët?

Nëse jo, kalojmë në votimin e projekt-aktit?

***Maksim Qoku:*** Dakord.

***Brunilda Kadi:*** Dakord.

***Dritan Hallunaj:*** Pro.

***Ilir Toska:*** Dakord.

***Alban Toro:*** Dakord.

***Fatmira Luli:*** Dakord.

***Marçela Shehu:*** Dakord.

***Erjon Muharremaj:*** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Gjyqtari i skemës së delegimit z. {...} caktohet për të gjykuar pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për periudhën deri më datë 02.06.2022.

2. Gjyqtari i skemës së delegimit z. {...} përjashtohet nga procedurat e shortit për caktimin e gjyqtarit relator në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për periudhën deri më datë 01.07.2021, me përjashtim të çështjeve në të cilat gjyqtarët e kësaj gjykate do të kenë pengesë ligjore për gjykimin e tyre.

3. Efektet juridike të vendimit fillojnë nga data e njoftimit.

4. Efektet financiare sipas këtij vendimi përballohen nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

5. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit z. {...}, sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 13 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 02.06.2021)*

**Pika 14 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së përshpejtuar të vlerësimit etik dhe profesional viti kalendarik 2019, për gjyqtarët që kanë plotësuar kriteret ligjore të kandidimit për ngritje në detyrë dhe që kanë ushtruar detyrën e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Brikena Ukperaj).<sup>13</sup>

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:50 dhe mbaroi në orën 15:11.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
- 3. Medi Bici*** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 5. Dritan Hallunaj*** (anëtar)

<sup>13</sup> Sipas rendit të ditës kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 13-ta.

- |                             |                  |
|-----------------------------|------------------|
| <b>6. Brunilda Kadi</b>     | <b>(anëtare)</b> |
| <b>7. Ilir Toska</b>        | <b>(anëtar)</b>  |
| <b>8. Alban Toro</b>        | <b>(anëtar)</b>  |
| <b>9. Brikena Ukperaj</b>   | <b>(anëtare)</b> |
| <b>10. Marçela Shehu</b>    | <b>(anëtare)</b> |
| <b>11. Erjon Muharremaj</b> | <b>(anëtar)</b>  |

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 4. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 5. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.**
- 6. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.**

#### **RENDI I DITËS:**

14. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së përshpejtuar të vlerësimit etik dhe profesional viti kalendarik 2019, për gjyqtarët që kanë plotësuar kriteret ligjore të kandidimit për ngritje në detyrë dhe që kanë ushtruar detyrën e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Brikena Ukperaj).

**Naureda Llagami:** Kalojmë në projekt-aktet e radhës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për fillimin e procedurës së përshpejtuar të vlerësimit etik dhe profesional viti kalendarik 2019, për gjyqtarët që kanë plotësuar kriteret ligjore të kandidimit për ngritje në detyrë dhe që kanë ushtruar detyrën e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë”. Për më shumë detaje fjalën ia jap zonjës Ukperaj.

**Brikena Ukperaj:** Faleminderit, zonja Kryetare!

Aktualisht Këshilli i Lartë Gjyqësor ka shpallur disa procedura për ngritjen në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe atyre të posaçëm, ku ndër kandidatat aplikues janë zoti Kalaja dhe z. {...}, të cilët pasi kanë kandiduar për disa pozicione dhe i kanë rikonsideruar këto kërkesa, së fundmi rezultojnë që të jenë kandidatë për plotësimin e vendeve vakante në gjykatat e apelit si më poshtë: 1. Gjyqtari {...} vijon kandidimin për ngritje në detyrë, në Gjykatën e Apelit Durrës dhe në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, të shpallura me vendimet nr.173 dhe nr.181, datë 28.05.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, procedura për të cilat ai është kualifikuar nga Këshilli. Ai ka kandiduar gjithashtu për ngritje në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 119, datë 01.04.2021, procedurë për të cilën vijon verifikimi.

2. Gjyqtari {...} vijon kandidimin për ngritje në detyrë, në Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr.187, datë 28.05.2020 dhe në Gjykatën e Apelit Durrës për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 392, datë 07.10.2020. Ky gjyqtar ka aplikuar gjithashtu për ngritje në detyrë për një pozicion në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, procedurë në vijim të së cilës, me vendimin e KLGJ nr. 162, datë 14.04.2021 është vendosur plotësimi i katër kriterëve të kandidimit për ngritje në detyrë, dhe vijimi i procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit.

Të dy kandidatët, bashkë me kërkesat e tyre për ngritjen në detyrë, për pozicionet në gjykatat e apeleve, kanë paraqitur pranë Këshillit edhe kërkesa individuale për kryerjen e vlerësimit etik dhe profesional të përsheptuar në zbatim të vendimit 97 të ligjit për Statusin, për vitin kalendarik 2019.

Këto kërkesa janë trajtuar së fundmi nga Komisioni pasi është plotësuar gjithë kuadri nënligjor i akteve që rregullojnë procesin e vlerësimit etik dhe profesional të ndihmësmagjistratëve në Gjykatën e Lartë.

Në këto kushte, Komisioni, pasi ka vlerësuar të dy kërkesat e kandidatëve si dhe vendimet respektive mbi të cilat ata janë kualifikuar në procedurat e ngritjes në detyrë, i propozon mbledhjes plenare, fillimin e procedurës së vlerësimit të përshpejtuar për secilin nga dy gjyqtarët, periudhë vlerësimi që përkon me vitin kalendarik 2019, për arsyet si më poshtë:

Së pari, për dy gjyqtarët, procedura e vlerësimit të përshpejtuar fillon mbi bazën e kërkesës së tyre së paraqitur në vitin 2020 e që lidhet me kandidimin për ngritje në detyrë, procedurë e cila ka filluar në vitin 2020 dhe është finalizuar me vendimet e marra në mbledhjet e datave 10.09.2020 dhe 20.11.2020. Duke qenë kërkesa të paraqitur në vitin 2020, por që nuk janë trajtuar deri tani pasi rregullat e vlerësimit të ndihmësmagjistratëve në Gjykatën e Lartë janë miratuar së fundmi, periudha e vlerësimit të përshpejtuar e tyre përkon me vitin e fundit kalendarik të ushtrimit të veprimtarisë së ndihmësmagjistratëve, që është konkretisht viti 2019;

Së dyti, ka të dhëna të mjaftueshme burimore për vlerësimin e të dy ndihmësmagjistratëve. Sa i përket veprimtarisë së tyre gjatë vitit kalendarik 2019, i kërkuar paraprakisht Gjykatës së Lartë informacion lidhur me numrin e çështjeve të përgatitura për relativim dhe të përfunduara. Referuar këtij informacioni rezulton se ndihmësmagjistrati {...} ka përfunduar në total gjatë vitit 2019, 237 çështje nga të cilat 112 janë përfunduar me vendim të Kolegjit, ndërsa ndihmësmagjistrati {...} ka përfunduar në total 206 çështje nga të cilat 104 janë përfunduar me vendim të Kolegjit përkatës të Gjykatës së Lartë.

Së treti, për të gjithë gjyqtarët që kanë kandiduar për ngritje në detyrë në Gjykatat e Apelit gjatë vitit 2020, periudha e vlerësimit është përcaktuar viti kalendarik 2019. Përcaktimi i së njëjtës periudhë kohore si periudhë vlerësimi për të gjithë subjektet që kandidojnë për ngritje në detyrë në të njëjtin nivel, krijon mundësi për kryerjen e procedurës së vlerësimit të përshpejtuar mbi bazën e të dhënave statistikore që i përkasin të njëjtës periudhë të veprimtarisë, duke garantuar barazi mes kandidatëve.

Së katërti, në respektim të nenit 97 të Ligjit 96/2016, gjyqtari {...} nuk ka asnjë vlerësim etik dhe profesional gjatë veprimtarisë së tij, ndërsa për gjyqtarin {...} vlerësimi

i fundit është realizuar para më shumë se 2 viteve. Gjyqtari është vlerësuar “shumë mirë” me vendimin nr.{...}, datë 18.11.2016 të ish-KLD-së për periudhën e vlerësimit 2010-2012.

Procesi i vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 1 janar 2019-31 dhjetor 2019 bazohet në të njëjtat të dhëna burimore të përcaktuara në kuadrin ligjor dhe nënligjor për vlerësimin e ndihmësmagjistratëve. Në këtë kuadër, Komisioni ka përgatitur edhe projektvendimin përkatës për fillimin e procedurës së përsheptuar të vlerësimit etik dhe profesional për të dy gjyqtarët që kanë plotësuar kriteret ligjore të kandidimit për ngritje në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, në Gjykatën Administrative të Apelit dhe Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, dhe që gjatë vitit 2019 kanë ushtruar detyrën e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë.

Në pikën e parë të projektvendimit përcaktohet pikërisht fillimi i kësaj procedure.

Në pikën e dytë përcaktohet caktimi i relatorit dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësimin për secilin nga dy gjyqtarët, proces i cili do të realizohet nëpërmjet shortit Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale për relatorin, dhe ndërmjet nëpunësve të Njësisë së Vlerësimit Etik dhe Profesional.

Lidhur me procedurën e shortit, Komisioni ka konsideruar që për përzgjedhjen e relatorit për secilin gjyqtar, të përfshihen vetëm dy anëtarët e Komisionit, znj. Kadi dhe z.Muharremaj si dhe dy nëpunësit përgjegjës për vlerësimin, znj. Esmerilda Habili dhe znj.Zeta Tërpollari, duke konsideruar angazhimin aktual të nëpunëses përgjegjëse për vlerësimin znj.Gilda Hoxha për përfundimin e raporteve të vlerësimit në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar. Faleminderit!

*Naureda Llagami:* Faleminderit, zonja Ukperaj!

Atëherë, ftoj stafin e administratës të fillojë procedurat e hedhjes së shortit për dy kandidatët.

Procedura e shortit:

Në vazon e parë të qelqit futen shiritat e letrës me emrat e gjyqtarëve: z. {...} dhe z. {...}.

Në vazon e dytë të qelqit futen shiritat e letrës me emrat e relatorëve sipas propozimit: znj. Brunilda Kadi dhe z. Erjon Muharremaj.

Në vazon e tretë të qelqit futen shiritat e letrës me emrat e nëpunësve përgjegjës sipas propozimit: znj. Esmerilda Habili Habili dhe znj. Zeta Tërpollari Tërpollari.

Tërhiqet fillimisht shiriti i letrës me emrin e gjyqtarit të parë, që i korrespondon z. {...}.

Relator për zoti Kalaja nga shorti rezulton i përzgjedhur z. Erjon Muharremaj dhe nëpunës përgjegjës për vlerësimin nga shorti rezulton e përzgjedhur znj. Zeta Tërpollari Tërpollari.

Tërhiqet shiriti i letrës me emrin e gjyqtarit të dytë, që i korrespondon z. {...}.

Relator për zotin Pëllumbi nga shorti rezulton i përzgjedhur znj. Brunilda Kadi dhe nëpunës përgjegjës për vlerësimin nga shorti rezulton e përzgjedhur znj. Esmerilda Habili Habili.

***Naureda Llagami:*** Faleminderit!

Kalojmë në votimin e projekt-aktit?

***Maksim Qoku:*** Dakord.

***Brunilda Kadi:*** Dakord.

***Dritan Hallunaj:*** Pro.

***Illir Toska:*** Dakord.

***Alban Toro:*** Dakord.

***Fatmira Luli:*** Dakord.

***Marçela Shehu:*** Dakord.

***Erjon Muharremaj:*** Pro.

***Brikena Ukperaj:*** Pro.

***Medi Bici:*** Pro.

***Naureda Llagami:*** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: I. Fillimin e procedurës së përshpejtuar të vlerësimit etik dhe profesional viti kalendarik 2019, për gjyqtarët që kanë ushtruar detyrën e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë dhe kanë plotësuar kriteret ligjore të kandidimit për ngritje në detyrë në Gjykatat e Apelit të juridiksionit të përgjithshëm, Gjykatën Administrative të Apelit dhe Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

II. Caktimin e relatorit dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësimin për secilin gjyqtar, si më poshtë:

1. Për gjyqtarin z. {...} - Relator z. Erjon Muharremaj - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Zeta Tërpollari.

2. Për gjyqtarin z. {...} – Relatore znj. Brunilda Kadi- Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Esmerilda Habili.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 14 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 02.06.2021)*

**Pika 15 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfshirjen e kandidatës znj. {...} në procedurat e komandimit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska).<sup>14</sup>

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:50 dhe mbaroi në orën 15:11.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku** (zëvendëskryetar)
- 3. Medi Bici** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli** (anëtare)
- 5. Dritan Hallunaj** (anëtar)
- 6. Brunilda Kadi** (anëtare)
- 7. Ilir Toska** (anëtar)

<sup>14</sup> Sipas rendit të ditës kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 14-ta.



8. *Alban Toro* (anëtar)  
9. *Brikena Ukperaj* (anëtare)  
10. *Marçela Shehu* (anëtare)  
11. *Erjon Muharremaj* (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
4. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
5. *Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
6. *Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

15. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfshirjen e kandidatës znj. {...} në procedurat e komandimit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska).

*Naureda Llagami:* Kalojmë në projekt-aktet e radhës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për përfshirjen e kandidatës znj. {...} në procedurat e komandimit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës dhe do relatohet nga zoti Toska.

*Ilir Toska:* Faleminderit!

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur një projekt-opinion mbi kandidaten që ka aplikuar për t’u komanduar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. {...}. Sipas projekt-opinionit të përgatitur:

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronja “ë”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 86, shkronja “d”, të Ligjit nr.115/2016

“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar dhe në nenet 53, 54, 57 dhe 58, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, mbi kërkesën e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Lartë Gjyqësor, me Vendimin nr. 200, datë 12.05.2021, ka shpallur kërkesën për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, në pozicionin “Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë”.

Afati i paraqitjes së kërkesave për komandim është përcaktuar deri më datë 26.05.2021.

Vendimi si më lart, sikundër edhe një njoftim publik, është publikuar po atë ditë, më datë 12.05.2021, në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Brenda afatit të caktuar për paraqitjen e kërkesave për komandim, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është paraqitur vetëm një kërkesë.

Konkretisht, më datë 26.05.2021, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është protokolluar, me aktin nr. {...}, kërkesa e znj.{...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, nëpërmjet të cilës ka shfaqur interes për t’u komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, në pozicionin e shpallur si “Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë”.

Duke qenë se Këshilli i Lartë Gjyqësor në rastin konkret, veç shpalljes së procedurës së komandimit është njëkohësisht dhe vetë institucioni që ka nevojë për gjyqtarin e komanduar, procedura e komandimit sipas Vendimit nr.200, datë 12.05.2020, kalon në dy faza verifikimi:

1. Në fazën e parë, brenda dy javëve pas përfundimit të afatit të aplikimit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës përgatit një projekt-opinion për çdo kandidat dhe vlerëson nëse komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin. Projekt-opinionin për çdo kandidat shqyrtohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor jo më vonë se një javë pas njoftimit të Kryetarit të Këshillit për përgatitjen e tyre. Opinionet e miratuara nga Këshilli publikohen në faqen zyrtare të tij. Këshilli mund të vendosë përjashtimin nga komandimi të kandidatit kur komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku ai ushtron funksionin ose kur

verifikohet që kandidati nuk plotëson ndonjë prej kushteve të tjera të komandimit. Ndërkohë, aplikimet e kandidatëve, për të cilët verifikohet plotësimi i kushteve të komandimit, i përcillen menjëherë për vlerësim dhe përzgjedhje Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Në fazën e dytë, procedura e komandimit vijon me verifikimin dhe vlerësimin e kritereve të kandidimit për kandidatët që nuk janë përjashtuar nga kandidimi në fazën e parë. Ky vlerësim bëhet nga Komisioni Ad Hoc i ngritur për këtë qëllim nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit, parashikuar kjo për analogji dhe për aq sa është e mundur, me rregullat për pranimin në shërbimin civil sipas legjislacionit për nëpunësin civil, ndërsa pozicioni për të cilin kërkohet komandimi i magjistratit bën pjesë në këtë shërbim. Ky Komision, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit, i paraqet këtij të fundit emrin e kandidatit të përzgjedhur për komandim.

Sa më sipër, në përgatitjen e këtij projekt-opinionit për kandidaten znj. {...}, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës verifikoi kushtet e komandimit, si dhe vlerësoi nëse komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku kandidatja ushtron funksionin, pra të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Kushtet e komandimit përcaktohen në nenin 53, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Po ashtu ato janë përcaktuar në pikën 6, të Vendimit të Këshillit nr. 200, datë 12.05.2021. Konkretisht, në këtë pikë të këtij vendimi përcaktohet se:

“Kushtet e komandimit janë:

- a) Komandimi nuk duhet të bjerë ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin e gjyqtarit;
- b) Kandidati nuk duhet të jetë në një pozicion me mandat të kufizuar;
- c) Kandidati nuk duhet të jetë i komanduar;
- ç) Kandidati, që ka qenë i komanduar më parë, duhet të ketë shërbyer jo më pak se pesë vjet si gjyqtar pas përfundimit të periudhës së mëparshme të komandimit;
- d) Kandidati nuk duhet të ketë masë disiplinore në fuqi”.

Lidhur me kushtet e komandimit sipas shkronjave “b”, “c”, “ç” dhe “d”, të pikës 6, të vendimit të sipërcituar të Këshillit, sipas informacionit të marrë, më datë 31.05.2021, nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, mbështetur në të dhënat e dosjes personale të kandidates, rezulton se:

Kandidatja ushtron detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, emëruar me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.478, datë 20.10.2020 dhe caktuar në pozicion me Vendimin e tij nr.519, datë 27.10.2020;

Kandidatja nuk ndodhet në një pozicion me mandat të kufizuar;

Kandidatja nuk është dhe as ka qenë më parë e komanduar;

Kandidatja nuk ka masë disiplinore në fuqi.

Sa më lart, verifikohet se kandidatja plotëson kushtet e komandimit, ndërsa për të nuk verifikohet të ekzistojë asnjë prej kushteve ndalues të komandimit.

Lidhur me kushtin e komandimit se ai nuk duhet të bjerë ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin e gjyqtarit, sipas shkronjës “a”, të vendimit të sipërcituar të Këshillit, nga informacioni i marrë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier dhe Opinioni i Kryetares së Gjykatës, dërguar me shkresën nr.{...} prot., datë 01.06.2021, rezulton se:

Sipas organikës aktuale në fuqi, numri i gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier është 14. Aktualisht në detyrë janë 11 gjyqtarë, ndërsa 2 gjyqtarë janë me leje të papaguar, njëri për periudhën deri më datë 31.12.2021 dhe tjetri për periudhën deri më datë 01.06.2022.

Ngarkesa aktuale e punës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier është 1004 çështje ose mesatarisht 84 çështje për gjyqtar.

Ngarkesa e gjyqtares {...} është 55 çështje.

Në opinionin e Kryetares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, sa i përket kandidimit të znj.{...}, ajo shprehet se: “Mendoj se në rastin konkret duhet vlerësuar fakti se ndërkohë punohet me organikë gati të plotë dhe me ngarkesë jo të lartë, dhe në rast largimi të gjyqtares nuk cenohet funksionaliteti i gjykatës”.

Në rrethanat si më lart, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës vlerëson se komandimi i znj. {...} pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, përballë ngarkesës së çështjeve që Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka aktualisht, sikundër dhe pritshmërisë pozitive që do të passjellin, në reduktimin e gjyqtarëve të nevojshëm për gjykimin e çështjeve penale, ndryshimet e bëra në Kodin e Procedurës Penale me Ligjin nr. 41/2021, nuk do të passjellë cenim, në një masë të atillë, të interesave të larta të kësaj gjykate, për sa kohë funksionaliteti i saj do të vijojë të ruhet.

Mbi sa më lart, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor që të vendosë: Miratimin e opinionit për përfshirjen e kandidatës znj. {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në procedurat e komandimit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Pika dy e projektvendimit bën fjalë për publikimin e këtij opinionit në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Pika tre bën fjalë se aplikimi i kandidatës znj. {...} i përcillet për vlerësim dhe përzgjedhje Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Së fundi, në projektvendim është parashikuar se ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

***Naureda Llagami:*** Faleminderit, zoti Toska!

Keni ndonjë diskutim?

Nëse jo, kalojmë në votimin e projekt-aktit të propozuar?

***Maksim Qoku:*** Dakord.

***Brunilda Kadi:*** Dakord.

***Dritan Hallunaj:*** Pro.

***Ilir Toska:*** Dakord.

***Alban Toro:*** Dakord.

***Fatmira Luli:*** Dakord.

***Marçela Shehu:*** Dakord.

***Erjon Muharremaj***: Pro.

***Brikena Ukperaj***: Pro.

***Medi Bici***: Pro.

***Naureda Llagami***: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Miratimin e opinionit për përfshirjen e kandidates znj. {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në procedurat e komandimit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Publikimin e këtij opinionit në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

3. Aplikimi i kandidates znj. {...} i përcillet për vlerësim dhe përzgjedhje Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 15 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 02.06.2021)*

**Pika 16 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska).<sup>15</sup>

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:50 dhe mbaroi në orën 15:11.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku** (zëvendëskryetar)
- 3. Medi Bici** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli** (anëtare)
- 5. Dritan Hallunaj** (anëtar)

<sup>15</sup> Sipas rendit të ditës kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 15-ta. Procesverbali i kësaj çështjeje të rendit të ditës është përmbledhje.

- |                             |                  |
|-----------------------------|------------------|
| <b>6. Brunilda Kadi</b>     | <b>(anëtare)</b> |
| <b>7. Ilir Toska</b>        | <b>(anëtar)</b>  |
| <b>8. Alban Toro</b>        | <b>(anëtar)</b>  |
| <b>9. Brikena Ukperaj</b>   | <b>(anëtare)</b> |
| <b>10. Marçela Shehu</b>    | <b>(anëtare)</b> |
| <b>11. Erjon Muharremaj</b> | <b>(anëtar)</b>  |

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 4. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 5. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.**
- 6. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.**

#### **RENDI I DITËS:**

16. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska).

Kjo çështje e rendit të ditës ka të bëjë me caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme.

Fjala i jepet relatorit të çështjes, z. Toska.

Relator i kësaj çështjeje është zoti Ilir Toska.

Zoti Toska parashtron se janë 5 gjykata që kanë paraqitur kërkesa për caktim gjyqtarësh në çështje gjyqësore të veçanta, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin.



Fillimisht zoti Toska relatton shkurtimisht radhën e shortit duke i propozuar Këshillit që procedurat e shortit të ndiqen sipas kësaj radhe:

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, Gjykata e Apelit Gjirokastrë, Gjykata e Apelit Korçë, Gjykata e Apelit Shkodër dhe Gjykata e Apelit Vlorë).

Vijohet me relatimin e relacionit të parë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë”

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë** ka paraqitur nevojë për 2 çështje gjyqësore.

Kërkesat e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë janë bërë në kushtet kur Këshilli i Lartë Gjyqësor ende nuk kishte marrë Vendimin nr. 191, datë 07.05.2021, “Për transferimin e përkohshëm me pëlqim të gjyqtarit z. {...}”, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, efektet e të cilit kanë filluar më datë 01.06.2021.

Për rrjedhojë, nevojat sipas kërkesave të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë aktualisht nuk ekzistojnë më, pasi nevoja për caktimin e 1 gjyqtari në çështjet respektive plotësohet përmes transferimit të përkohshëm të gjyqtarit {...}.

Në këto kushte, kërkesat si më lart të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë tashmë ka mbetur pa objekt, prandaj është vendi që Këshilli të vendosë për deklarimin e përfunduar të çështjes pa një vendim përfundimtar, bazuar në nenin 90/3 dhe 95 të Kodit të Procedurave Administrative, Kod rregullimet e të cilit duhet të zbatohen nga Këshilli në çdo rast ose situatë tjetër që nuk parashikohet shprehimisht nga Ligji nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes si sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, sikurse përcakton neni 97/3 i tij.

Sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor të vendosë: Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesave të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë si vijon:

1. Kërkesës nr. {...} prot., datë 26.04.2021, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore që iu përket palëve: paditëse: (emrat e palëve dhe objekti).

2. Kërkesës nr. {...} prot., datë 04.05.2021, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore që iu përket palëve: paditës: (emrat e palëve dhe objekti).

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimit të Komisionit, ndaj propozimi konsiderohet i miratuar.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të dytë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Gjirokastrë**, ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore, me karakter “tepër urgjent” në lëndë penale.

Kërkesa e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë është bërë në kushtet kur ende nuk kishin hyrë në fuqi ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale sipas Ligjit nr.41/2021. Ky ligj është botuar në Fletoren Zyrtare nr.71, datë 14.05.2021 dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit, pra më datë 29.05.2021.

Në nenin 14, të Kodit të Procedurës Penale, titulluar “Gjykatat e apelit dhe përbërja e tyre”, sipas ndryshimeve që ka pësuar pika 4, parashikohet se: “4. Gjykimet për kërkesat e parashikuara në pikën 2 të nenit 13 të këtij Kodi, shqyrtohen nga një gjyqtar i vetëm”.

Ndërkohë, në pikën 2, të nenit 13, të Kodit të Procedurës Penale, parashikohet se: “2. Gjykatat e rretheve gjyqësore dhe Gjykata e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar gjykojnë me një gjyqtar: a) kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake; b) ankimi ndaj vendimit të prokurorit për mosfillimin e ndjekjes penale apo pushimin e çështjes për kundërvajtjet penale; c) kërkesa e prokurorit për pushimin e akuzës ose çështjes për krimet; ç) kërkesën e prokurorit për dërgimin e çështjes në gjyq; d) kërkesën e prokurorit për miratimin e urdhrin penal; dh) kërkesat që lidhen me ekzekutimin e vendimeve penale; e) kërkesat për rivendosje në afat; ë) kërkesat që lidhen me marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja, sipas titullit X të këtij Kodi; f) çdo kërkesë tjetër të parashikuar në këtë Kod apo në ligje të veçanta”.

Në rastin konkret, çështja penale për të cilën paraqet nevojë Gjykata e Apelit Gjirokastrë klasifikohet sipas shkronjës “b”, pika 2, neni 13, të Kodit të Procedurës

Penale, çka e lidhur me përcaktimin e bërë në pikën 4, të nenit 14, të këtij Kodi, do të thotë se tashmë kjo çështje në gjykatën e apelit shqyrtohet nga një gjyqtar i vetëm.

Në këto kushte, sa kohë rregullimet procedurale janë menjëherë të zbatueshme, rezulton se nevoja e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë për caktimin e një gjyqtari, tashmë nuk ekziston, pasi çështja shqyrtohet nga gjyqtar i vetëm dhe gjykata ka 2 gjyqtarë që nuk kanë pengesë ligjore për gjykimin e saj.

Ndaj sa më lart, është vendi që Këshilli të vendosë për deklarimin e përfunduar të çështjes pa një vendim përfundimtar, bazuar në nenin 90/3 dhe 95 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe referuar nenit 97/3 të Ligji nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes si sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Mbi këtë bazë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor të vendosë: Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesës së Gjykatës së Apelit Gjirokastrë si vijon: 1. Kërkesës nr. {...} prot., datë 05.06.2021, për caktimin e një gjyqtari, në çështjen gjyqësore që iu përket palëve: (emri i palës dhe objekti).

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimit të Komisionit, ndaj propozimi konsiderohet i miratuar.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të tretë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Korçë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Korçë**, ka paraqitur nevojë në 1 çështje, me karakter “tepër urgjent” në lëndë penale.

Për të njëjtat argumente që u parashtruan më lart, edhe sa i përket kësaj gjykate, Komisioni i propozon Këshillit që të vendosë: Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesës së Gjykatës së Apelit Korçë si vijon:

Kërkesës nr. {...} prot., datë 27.05.2021, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore që iu përket palëve: (emrat e palëve dhe objekti).

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimit të Komisionit, ndaj propozimi konsiderohet i miratuar.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të katërt “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Shkodër”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Shkodër**, ka paraqitur nevojë në 5 çështje gjyqësore, me karakter “tepër urgjent”, 4 në lëndë penale dhe 1 në lëndë civile.

Edhe këto kërkesa të Gjykatës së Apelit Shkodër janë bërë kur ende nuk kishin hyrë në fuqi ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale sipas Ligjit nr.41/2021, si dhe ndryshimet në Kodin e Procedurës Civile sipas Ligjit nr.44/2021. Këto ligje janë botuar në Fletoren Zyrtare nr.71, datë 14.05.2021 dhe kanë hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit, pra më datë 29.05.2021.

Lidhur me kërkesat me numër rendor 1-3, për nevojat e Gjykatës së Apelit Shkodër për çështjet në lëndë penale, janë të njëjtat situata si për dy gjykatat që përmenda më përpara (Gjykatën e Apelit Gjirokastrë dhe Korçë). Të tre këto çështje klasifikohen nën pikën 2 të nenit 13 të Kodit të Procedurës Penale, të cilat sipas pikës 4 të nenit 14 të këtij Kodi tashmë gjykohen nga një gjyqtar i vetëm.

Lidhur me çështjen me numër rendor 4 (lënë penale), kjo kërkesë e Gjykatës së Apelit Shkodër u paraqit më datë 31 maj 2021, ndërkohë që ende pa u trajtuar kushtet e pranueshmërisë së kësaj kërkesë, vetë Gjykata e Apelit Shkodër, më datë 02.06.2021 e tërhoqi atë.

Sa i përket kërkesës me nr. rendor 5, që është në lëndë civile, në nenin 35 të Kodit të Procedurës Civile, në paragrafin e katërt, sipas shtesave që ka pësuar, ky Kod parashikohet se: “Gjykata e apelit shqyrton çështjen me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë. Gjykata e apelit shqyrton me një gjyqtar të vetëm ankimet kundër vendimeve për paditë me vlerë deri në njëzetfishetin e pagës minimale në shkallë vendi, që rrjedhin nga marrëdhënie kontraktore, ankimin e veçantë kundër vendimit të refuzimit të kërkesës për lëshimin e urdhrat të ekzekutimit, ankimet e veçanta kundër vendimit të gjykatës që ka shqyrtuar kundërshtimin e veprimeve të përmbaaruesit gjyqësor, si dhe rastet e tjera të parashikuara në këtë Kod”.

Pikërisht në nenin 75 të Kodit të Procedurës Civile, në paragrafin e dytë, sipas ndryshimeve që ka pësuar ky Kod, parashikohet se: “Për kërkesën e përjashtimit të gjyqtarit të gjykatës së apelit vendos një gjyqtar tjetër i kësaj gjykate, i ndryshëm nga gjyqtarët e trupit gjykues të cilit i përket gjyqtari që kërkohet të përjashtohet. Vendimi është i formës së prerë”.

Në rastin konkret, çështja civile për të cilën paraqet nevojë Gjykata e Apelit Shkodër klasifikohet sipas paragrafit të dytë, neni 75, i Kodit të Procedurës Civile, çka e lidhur edhe me përcaktimin e bërë në paragrafin e katërt, të nenit 35, të këtij Kodi, do të thotë se tashmë kjo çështje në gjykatën e apelit shqyrtohet nga një gjyqtar i vetëm.

Në këto kushte, sa kohë rregullimet procedurale janë menjëherë të zbatueshme, rezulton se nevoja e Gjykatës së Apelit Shkodër për caktimin e një gjyqtari, tashmë nuk ekziston, pasi çështja shqyrtohet nga gjyqtar i vetëm dhe gjykata ka 1 gjyqtar që nuk ka pengesë ligjore për gjykimin e kësaj çështjeje.

Ndaj sa më lart, është vendi që Këshilli të vendosë për deklarin e përfunduar të çështjes pa një vendim përfundimtar, bazuar në nenin 90/3, 94/1 dhe 95 të Kodit të Procedurave Administrative, rregullimet e të cilit duhet të zbatohen nga Këshilli sipas përcaktimit të nenit 97/3 të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes si sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Mbi sa më lart, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor të vendosë: Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesës së Gjykatës së Apelit Shkodër si vijon:

1. Kërkesës nr. {...} prot., datë 04.05.2021, për caktimin e një gjyqtari, në çështjen gjyqësore që iu përket palëve: (emri i palëve dhe objekti).

2. Kërkesës nr. {...} prot., datë 19.05.2021, për caktimin e një gjyqtari, në çështjen gjyqësore që iu përket palëve: Kërkues: (emri i palëve dhe objekti).

3. Kërkesës nr. {...} prot., datë 27.05.2021, për caktimin e dy gjyqtarëve, në çështjen gjyqësore që iu përket palëve: Kërkues: (emri i palëve dhe objekti).

4. Kërkesës nr.{...} prot., datë 27.05.2021, për caktimin e dy gjyqtarëve, në çështjen gjyqësore që iu përket palëve: Kërkues: (emri i palëve dhe objekti).

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimit të Komisionit, ndaj propozimi konsiderohet i miratuar.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të pestë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Vlorë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Vlorë**, ka paraqitur nevojë në 5 çështje gjyqësore, 2 në lëndë penale dhe 3 në lëndë civile.

Kërkesat e Gjykatës së Apelit Vlorë janë bërë në kushtet kur ende nuk kishin hyrë në fuqi ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale dhe në Kodin e Procedurës Civile.

Lidhur me kërkesat me numër rendor 1-3, për nevojat e Gjykatës së Apelit Vlorë për çështjet në lëndë civile, janë të njëjtat parashtrime që bëra edhe pak më herët në rastin e Gjykatës së Apelit Shkodër, sa i përket parashikimit të paragrafit 4 të nenit 35 të Kodit të Procedurës Civile, si dhe paragrafit 2 të nenit 75 të këtij Kodi.

Në rastin konkret çështjet civile për të cilat paraqet nevojë Gjykata e Apelit Vlorë klasifikohen sipas fjalisë së dytë, të paragrafit të katërt, të nenit 35, të Kodit të Procedurës Civile dhe sipas paragrafit të dytë, të nenit 75, të këtij Kodi, çka do të thotë se tashmë këto çështje në gjykatën e apelit shqyrtohet nga një gjyqtar i vetëm.

Në këto kushte, sa kohë rregullimet procedurale janë menjëherë të zbatueshme, rezulton se nevoja e Gjykatës së Apelit Vlorë për caktimin e një dhe dy gjyqtarëve, tashmë nuk ekziston, pasi çështjet shqyrtohet nga gjyqtar i vetëm dhe gjykata ka 1 ose 2 gjyqtarë që nuk kanë pengesë ligjore për gjykimin e tyre.

Lidhur me kërkesat me numër rendor 4-5, për nevojat e Gjykatës së Apelit Vlorë për çështjet në lëndë penale, janë të njëjtat përcaktime ligjore të pikës 4, të nenit 14 të Kodit të Procedurës Penale, të ndryshuar, sikundër dhe të pikës 2 të nenit 13 të këtij Kodi.

Në rastin konkret, çështjet penale për të cilat paraqet nevojë Gjykata e Apelit Vlorë klasifikohen sipas shkronjave “b” dhe “c”, pika 2, neni 13, të Kodit të Procedurës

Penale, çka e lidhur me përcaktimin e bërë në pikën 4, të nenit 14, të këtij Kodi, do të thotë se tashmë këto çështje në gjykatën e apelit shqyrtohet nga një gjyqtar i vetëm.

Në këto kushte, sa kohë rregullimet procedurale janë menjëherë të zbatueshme, rezulton se nevojat e Gjykatës së Apelit Vlorë për caktimin e gjyqtarëve, tashmë ekziston në një masë më të vogël, pasi në dy raste ka kërkuar caktimin e tre gjyqtarëve Gjykata e Apelit Vlorë.

Ndaj sa më lart, sa i përket kërkesave me numër rendor 1-3, të Gjykatës së Apelit Vlorë, është vendi që Këshilli të vendosë për deklarimin e përfunduar të çështjes pa një vendim përfundimtar, bazuar në nenin 90/3 dhe 95 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe nenit 97/3 të Ligji nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes si sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Për kërkesat me nr. rendor 4-5 Këshilli duhet të vendosë vijimin e shqyrtimit të tyre duke konsideruar nevojën e gjykatës në këto çështje penale vetëm me 1 gjyqtar.

Sa më lart, Komisioni i propozon KLGJ-së që të vendosë: Deklarimin e përfunduar pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesës së Gjykatës së Apelit Vlorë si vijon:

1. Kërkesës nr.{...} prot., datë 05.05.2021, për caktimin e dy gjyqtarëve, në çështjen gjyqësore që iu përket palëve: (emrat e palëve dhe objekti).
2. Kërkesës nr. {...} prot., datë 05.05.2021, për caktimin e dy gjyqtarëve, në çështjen gjyqësore që iu përket palëve: (emrat e palëve dhe objekti).
3. Kërkesës nr.{...} prot., datë 18.05.2021, për caktimin e një gjyqtari, në çështjen gjyqësore që iu përket palëve: (emrat e palëve dhe objekti).

Vijimin e shqyrtimit të kërkesave me numër rendor 4 dhe 5, për caktimin e një gjyqtari.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimit të Komisionit, ndaj propozimi konsiderohet i miratuar.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Apelit Vlorë për kërkesat me nr. rendor 4-5, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat

dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” si dhe ligjin për Statusin, pikërisht nenin 170/1, dispozitë e shtuar përmes ndryshimeve të bëra në ligjin nr. 50/2021.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Gjirokastrë, përfshirë dhe gjyqtarin e skemës së delegimit të caktuar në këtë gjykatë.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 2.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti Kryetari në detyrë i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, konkretisht: Z. Dritan Banushi.

Në shortimin e çështjes nr.4 të përjashtohet nga shorti gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë që ka pengesë ligjore për gjykimin e saj, konkretisht: Znj. Irena Brahimi.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 4, penale, gjyqtarja Miranda Andoni.

Për çështjen nr. 5, penale, gjyqtari Enton Dhimitri.

Me kaq mbyllet procedurat e shortit dhe në tërësi e gjithë mbledhja plenare.

\* \* \*

(Pika 16 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**